



USHTRIA



Viti i 74-të i botimit Nr. 20 (827718)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 Maj 2021

Gjeneralmajor Begaj priti atashetë ushtarakë të SHBA-së



David H. Millner do të jetë atashetë i ri ushtarak i SHBA-së

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi më 11 maj, një takim me atashetë ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kapiten i Rangut të I-rë James Hilton, në kuadër të përfundimit të mandatit të atashetë ushtarak rezident në Tiranë. Gjeneralmajor Begaj,

vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, bashkëpunim i konkretizuar së fundmi edhe me stërvitjen "Defender Europe 21", ku Shqipëria është bërë vend mikpritës. Gjatë takimit u prezantua atashetë i ri ushtarak i SHBA-së, Kapiten i Rangut...

» faqe 2

Intervistë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi

Kapacitetet tona ushtarake vlejné për ne, por edhe për aleatët në NATO



» faqe 3

Kapiteni i rangut të I-rë James Hilton, përfundoi detyrën në Shqipëri Ministri Peleshi vlerëson me "Medaljen e Mirënjohjes" atashetë ushtarak amerikan

Motivacioni: "Për kontributin e veçantë të dhënë nëpërmjet punës së tij si atashetë ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mbështetjen dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë"

» faqe 3



Stërvitja "Defender Europe 21"

Rinas: Trupat amerikane dislokohen në Qendrën e Kontroll-Raportimit

Në Forcën Ajrore në garnizonin Rinas, në kuadër të Stërvitjes "Defender Europe 21", u dislokuan trupat amerikane në Sallën Operacionale të Qendrës së Kontroll - Raportimit, për fillimin e stërvitjes "Astral Knight 21". Kjo stërvitje do të fillojë në gjysmën e dytë të muajit maj 2021 dhe ka për qëllim integrimin dhe ndërveprimin e komunikimit midis Sallës Operacionale...



» faqe 4

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit

Zhvillohet stërvitja planëzuese "Marqineti 21-01"

Në kuadër të programit akademik për vitin 2020-2021, gjatë katër ditëve nga data 26 prill deri më 30 prill 2021, në ambjentet e AFA-së, me kursantët e Kursit të Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH) u zhvillua stërvitja planëzuese "Marqineti 21-01". Objektivat kryesore të kësaj stërvitje ishin: Organizimi, funksionimi...

» faqe 5



JENS STOLTENBERG, MESAZH TALIBANËVE

Çdo sulm ndaj trupave të NATO-s do ketë një përgjigje të fuqishme

» faqe 10

LIBRI I NJË GJENERALI

Gjeneralmajor Spiro Shalësi dhe libri i tij "Për artin ushtarak shqiptar"

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

» faqe 6

GJENERALMAJOR BAJRAM BEGAJ

Dy vite nga rënia në krye të detyrës e major Tanushit dhe nëntetare Hasanaj

» faqe 7

Gjeneralmajor Begaj priti atashetë ushtarakë të SHBA-së

David H. Millner do të jetë
atasheu i ri ushtarak i SHBA-së

Kapiten i Rangut të II-të David H. Millner është diplomuar si Oficer i Inteligjencës Detare në vitin 2002. Ai gjithashtu është një njohës i mirë i gjuhës shqipe



Afganistan, Japoni, Itali dhe Kili. Ai gjithashtu është një njohës i mirë i gjuhës shqipe. Në përfundim të takimit, u zhvillua një ceremoni e shkurtër me prezencën e titullarëve më të lartë ushtarakë të FARSH-it. Gjatë kësaj ceremonie Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, i akordoi Kapitenit të Rangut të I-rë James Hilton, "Certifikatë Vlerësimi", me motivacionin: "Për kontribut të shquar në rritjen e nivelit të bashkëpunimit ushtarak midis Forcave të Armatosura të SHBA-së dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë".

Atashetë ushtarak amerikanë
në komandën e Forcës Ajrore

Në takim u diskutua gjithashtu roli, kontributi i Forcës Ajrore dhe mbarëvajtja e Stërvitjes "Defender Europe-21"

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore, kolonel Ylli Pulaj priti në një takim zyrtar atashetë ushtarak të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kapiten i rangut I James Hilton, me rastin e përfundimit të mandatit të tij si atashetë ushtarak rezident në Tiranë si dhe atashetë e ri ushtarak të SHBA, kapiten i rangut II David H. Millner.

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore pasi i uroi mirëseardhjen në komandën e Forcës Ajrore, theksoi mbështetjen dhe bashkëpunimin e shkëlqyer me atashetë ushtarak amerikan dhe Zyrën Amerikane të Bashkëpunimit në fushën e Mbrojtjes, bashkëpunim ky, i cili do jetësohet me projektet madhore të modernizimit të Forcës Ajrore me marrjen e helikopterëve Black Hawk dhe mirëmbajtjes së tyre por edhe të trajnimit e kualifikimit të ekuipazheve fluturuese.

Atashetë ushtarakë shprehën falënderimet për mikpritjen duke siguruar për vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi të shkëlqyer me



Atashetë ushtarakë shprehën falënderimet për mikpritjen duke siguruar për vazhdimësinë e këtij bashkëpunimi të shkëlqyer me projektet që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve ajrore operacionale dhe modernizimin e Forcës Ajrore.

projektet që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve ajrore operacionale dhe modernizimin e Forcës Ajrore.

Në takim u diskutua gjithashtu roli, kontributi i Forcës Ajrore dhe mbarëvajtja e Stërvitjes "De-

fender Europe-21" si dhe rritja e pjesëmarrjes në stërvitje të tilla të përbashkëta por edhe gamës së bashkëpunimeve e projekteve që lidhen me zhvillimin e Forcës Ajrore dhe strukturave të saj.

Stërvitja "Defender Europe 21"

Gjeneralmajor Christopher
O. Mohan viziton Bazën
Ajrore Kuçovë

Më 6 maj, paradite në Bazën Ajrore Kuçovë zhvilloi një vizitë komandanti i Komandës Mbështetëse të Forcave Tokësore të SHBA-së për Europën dhe Afrikën, gjeneralmajor Christopher O. Mohan, për të parë nga afër dhe inspektuar bazën dhe trupat amerikane të dislokuara në kuadër të stërvitjes "Defender Europe 21". Gjeneralmajor Mohan u prit nga shefi i Shtabit i Forcës Ajrore kolonel Arben Cenolli. Gjeneralmajori Mohan shprehu falënderimet për bashkëpunimin dhe mbështetjen e trupave amerikane dhe të forcave të tjera pjesëmarrëse në këtë stërvitje. Më pas ata inspektuan dhe u njohën me Bazën Ajrore Kuçovë. Në fund të vizitës gjeneralmajor Mohan pati një takim të veçantë me komandantin e Bazës Ajrore Kuçovë.

Kapiteni i rangut të I-rë James Hilton, përfundoi detyrën në Shqipëri

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, priti më 11 maj, në një takim kortezie atasheun ushtarak të SHBA-së në Tiranë, kapitenin i rangut të I-rë James Hilton, i cili këto ditë përfundon mandatin e tij dhe largohet nga vendi ynë.

Në ceremoninë e organizuar për nder të kapitenit të rangut të I-rë Hilton, ministri i Mbrojtjes Peleshi i dorëzoi ushtarakut të lartë amerikan “Medaljen e Mirënjohjes” me motivacionin: “Për kontributin e veçantë të dhënë nëpërmjet punës së tij si atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mbështetjen dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Duke vlerësuar punën dhe kontributin e atasheut ushtarak të SHBA-së në Tiranë, ministri Peleshi u shpreh se: “Kapiten Hilton do të mbahet mend si një ushtarak i devotshëm, i cili e kreu detyrën e tij me profesionalizëm të lartë, por mbi të gjitha do të mbahet mend si një mik i vyer i Ministrisë së Mbrojtjes, Forcave të Armatosura dhe vendit tonë.”

Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes i uroi mirëseardhjen në vendin tonë edhe kapitenit të rangut të II-të,

Ministri Peleshi vlerëson me “Medaljen e Mirënjohjes” atasheun ushtarak amerikan

Motivacioni: “Për kontributin e veçantë të dhënë nëpërmjet punës së tij si atashe ushtarak i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, në mbështetjen dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”



David Millner, i cili ka marrë detyrën e atasheut të ri ushtarak të SHBA-së në Shqipëri. Ministri Peleshi siguroi atasheun e ri të SHBA-së se bashkëpunimi në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, me të dhe vendin të cilin ai përfaqëson, është një nga prioritetet kryesore të Ministrisë së Mbrojtjes.

Më pas, dy ushtarakët e lartë amerikanë u pritën edhe nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, i cili falënderoi kapitenin e rangut të I-rë Hilton, të cilit i dorëzoi certifikatën e mirënjohjes për kontributin e tij në forcimin e bashkëpunimit mes FA shqiptare dhe atyre amerikane.

Intervistë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi

Kapacitetet tona ushtarake vlejné për ne, por edhe për aleatët në NATO

Zoti ministër, në stërvitjen e madhe ushtarake “Defender Europe 21” marrin pjesë 28 mijë trupa nga 26 vende anëtare dhe partnere të NATO-s, po çfarë do të thotë kjo për Shqipërinë?

Kjo stërvitje është më e madhja e zhvilluar në vendin tonë ndonjëherë, në historinë tonë, madje edhe në rajonin tonë, të paktën në dekadën e fundit nuk ka patur një stërvitje më të madhe se kjo. Shqipëria ka fatin e madh, por nuk është çështje fati, besoj, jam i bindur, është edhe e zgjedhur si e tillë, që të jetë vendi pritës. Porti i Durrësit është porti kryesor i zbarkimeve të trupave, krahas shumë porteve të tjera, të cilat janë rreth 5 porte dhe 12 aeroporte që marrin pjesë në të gjitha vendet europiane, të angazhuara në këtë stërvitje. Porti i Durrësit po testohet si i tillë. Duhet thënë se fillojnë një seri stërvitjesh “Defender” nga ky vit, ku çdo vit, në vitet tek, stërvitjet do të zhvillohen në Europën Jugore, kurse në vitet çift, stërvitja do të zhvillohet në Europën Veriore, në vendet Balltike. Ne shpresojmë dhe janë të gjitha gjasat që Shqipëria nuk do të jetë viti pritës vetëm për “Defender Europe 21”, por edhe “Defender Europe 23”, “Defender Europë 25” e në vazhdim, pra në çdo vit tek, kur stërvitja do të zhvillohet në jug.

Rëndësia e stërvitjes ndërkom-bëtare ushtarake “Defender Europe 21”, duket edhe nga fakti që në ceremoninë e zhvilluar në portin e Durrësit më 4 maj 2021, ishin të pranishëm Kryeministri Rama, Presidenti Meta, tre gjenerale të NATO-s, midis tyre Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europianë të NATO-s, Tod Walters, Ambasadorja e SHBA-së në Tiranë, Yuri Kim, trupi diplomatik, atashe ushtarakë, etj. Po për njeriun e thjeshtë, për çfarë duhen këto stërvitje



kaq të mëdha, kaq të rëndësishme?

Këto stërvitje janë stërvitje ushtarake në shërbim të paqes dhe NATO është aleanca më e madhe botërore politike dhe ushtarake, ne jemi pjesë e saj, një nga zhvillimet më të rëndësishme pas viteve 90 për vendin tonë, në pozicionimin në strategjik dhe më të fortë, atë të Shqipërisë në krah të perëndimit, një prirje natyrale dhe historike e Shqipërisë. Stërvitjet ushtarake zhvillohen në një botë e cila nuk është ashtu siç do të donim të gjithë të ishte, pra nuk është e gjitha e qetë duke parë zhvillimet gjeopolitike. Ka forca të ndryshme, kemi forca rivale. Rajoni i ballkanit, ballkani perëndimor, është një terren ku ndeshen edhe forcat rivale ndaj vlerave tona, ku ndeshen interesa të ndryshme. Prandaj kjo stërvitje ka interes strat-

egjik të cilin e kemi përmendur shpesh. Ne na çimenton si vend strategjik për aleancën euroatlantike, por edhe për vendet e ballkanit perëndimor, ku shqipëria ka një rol të rëndësishëm për të luajtur. Jetojnë shqiptarë në pesë shtete të Ballkanit, ne jemi një vend që nuk ka përplasje etnike, nuk kemi asnjë forcë politike që të ketë axhendë tjetër, përveç axhendës integruese euroatlantike. Ne jemi vendi pritës i kësaj stërvitjeje, nga këtu hyjnë dhe zbarkojnë të gjitha trupat, ku porti i Durrësit është porti kryesor i kësaj stërvitjeje. Jo vetëm pozicioni ynë strategjik, por edhe qasja jonë perëndimore dhe proamerikanizmi ynë ka rol të veçantë.

Në ditën e hapjes të “Defender Europe 21”, apo Ditën e Vizitorëve të Shquar, Ambasadorja e SHBA-së

në Tiranë, Yuri Kim, në fjalën e saj tha se “nuk u zgjodh rastësisht Shqipëria dhe se roli i Shqipërisë është më i rëndësishëm se kurrë”, si duhet ta kuptojmë këtë deklaratë të diplomates amerikane?

Së pari: pozicioni i jashtëzakonshëm strategjik; së dyti: roli i madh që ne luajmë dhe mund të luajmë në Ballkanin Perëndimor për ta mbajtur orientimin e këtij rajoni të rëndësishëm nga perëndimi; së treti: miqësia apo lidhja shumë e fortë që ne kemi me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe perëndimin dhe së katërti: zgjedhja jonë për të patur si partner strategjik Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Duhet thënë se stërvitja “Defender Europe 21”, organizohet nga Komanda Europiane e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në kuadrin dhe standartet e NATO-s

Zoti ministër, flitet se në të kaluarën ushtria jonë ka qënë e fuqishme me avionë reaktivë, avionë luftarakë, kundërajrorë, etj.. Çfarë mund të themi për ushtrinë shqiptare sot, potencialin e saj dhe a janë ushtarakët tanë në nivelin e homologëve të Aleatëve, në aspektin profesional?

Padyshim që në përmasa, nuk mund të krahasohemi me çmendurinë e sistemit të kaluar ku “gjithë populli ishin ushtarë” dhe ku kishte tjetër qasje. Sot lajm i mirë është se ne jemi pjesë e një aleance të madhe me të cilën ndajmë role, qasemi në të njëjtat standarte, marim përsipër atë që na takon. Duhet thënë se ne jemi një vend i vogël, në Aleancën e madhe të NATO-s, por kontributi ynë nuk është në proporcion

me madhësinë e këtij vendi. Kontributi ynë është shumë herë më i madh, siç është pjesëmarrja jonë në misionet e NATO-s, apo operacionet e NATO-s si në Afganistan, Irak, Kosovë, Letoni, Sudanin e Jugut. Ushtarakët tanë kanë dhënë jetën në misionet ndërkombëtare si në Afganistan apo Letoni.

Në ditën e hapjes të “Defender Europe 21”, apo Ditën e Vizitorëve të Shquar, morën pjesë tre gjeneralë amerikanë me katër yje. Gjeneral Tod Walters, Komandant i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europianë të NATO-s; Gjeneral Jeffrey Harrigan, Komandant i Forcave Ajrore të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Europë-Forcave Ajrore Afrikë, si dhe Komandës Ajrore Aleatë; dhe Gjeneral Christopher Cavoli, Komandant i Ushtrisë së SHBA në Europë dhe Afrikë. Pra një prezencë e jashtëzakonshme, domethënëse.

Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Komandant Suprem i Aleatëve Europianë të NATO-s, Tod Walters, në fjalën e tij në Durrës e cilësoi Shqipërinë “eksportues të sigurisë” dhe ka përshëndetur dhe vlerësuar rolin e madh që ne luajmë në NATO. Po të shohim matricën e trupave ushtarake në Afganistan, ku po tërhiqemi sipas vendimit të përbashkët të Aleancës, ne kemi kontribut të rëndësishëm. Ne perpiqemi të tregojmë se nuk jemi thjeshtë një vend prezent, por jemi një vend me kontribute të çmuara atje, e tregojmë nga pjesëmarrja në misione, por e tregojmë edhe nëpërmjet faktoreve që i vlejné NATO-s. Unë mendoj se një vend i vogël dhe në zhvillim si Shqipëria nuk ka nevojë të kompleksohet se është i fundit në të gjitha standartet. Ne nuk mund të ndërtojmë dot batalione të mëdha, por ne kemi aftësinë për të zhvilluar kapacitete që iu vlejné jo vetëm Shqipërisë, por edhe aleatëve në NATO.

Stërvitja “Defender Europe 21”

Rinas: Trupat amerikane dislokohen në Qendrën e Kontroll-Raportimit

Stërvitja fillon në gjysmën e dytë të muajit maj 2021 dhe ka për qëllim integrimin dhe ndërveprimin e komunikimit midis Sallës Operacionale të Qendrës së Kontroll-Raportimit në Shqipëri me Qendrën Operacionale të Ushtrisë Amerikane në Europë

Në Forcën Ajrore në garnizonin Rinas, në kuadër të Stërvitjes “Defender Europe 21”, u dislokuan trupat amerikane në Sallën Operacionale të Qendrës së Kontroll - Raportimit, për fillimin e stërvitjes “Astral Knight 21”.

Kjo stërvitje do të fillojë në gjysmën e dytë të muajit maj 2021 dhe ka për qëllim integrimin dhe ndërveprimin e komunikimit midis Sallës Operacionale të Qendrës së Kontroll-Raportimit në Shqipëri me Qendrën Operacionale të Ushtrisë Amerikane në Europë si dhe shkëmbimin e ekspertizës profesionale të ekipeve respektive.

Ekipet ushtarake të Sallës Operacionale në Qendrën e Kontroll - Raportimit të Forcave të Armatosura Shqiptare gjatë kësaj stërvitjeje do të familjarizohen gjithashtu dhe aftësohen të komunikojnë e ndërveprojnë së bashku me kolegët ushtarakë amerikanë sipas standardeve të NATO-s.



“Defender Europe 21”

Stërvitje e përbashkët me grupin amerikan në Bazën e Pashalimanit

Në kuadër të zhvillimit në vendin tone, të stërvitjes së përbashkët me Komandën e Ushtrisë Amerikane në Europë të koduar “Defender Europe 21”, në Flotiljen Detare Pashaliman është zhvilluar nga dita e premte deri ditën e hënë një aktivitet i përbashkët ndërmjet grupit amerikan të zhytjes në bashkëpunim me zhytësit e Qendrës së Zhytjes Pashaliman. Aktiviteti është zhvilluar në anijen spitaliere të mbytur në gjirin e Radhimës dhe brenda Bazës Pashaliman pranë nëndetësës 105. Gjatë aktivitetit në vijimësi është zhvilluar dhe ngjitje në malin e Sevasterit. Në përfundim të aktivitetit grupi pjesëmarrës amerikan ka vlerësuar personelin e Bazës Pashaliman nënlejtënant Klaudio Lutaj, nënlejtënant Inert Filaj dhe komandantin e Flotiljes Pashaliman kapiten i rangut të II-të Sabri Gjinollari me certifikata mirënjohje, në shenjë vlerësimi, falënderimi dhe mirënjohje për gjithë zhvillimin, pritjen dhe organizimin e aktivitetit.



Aktiviteti është zhvilluar në anijen spitaliere të mbytur në gjirin e Radhimës dhe brenda Bazës Pashaliman pranë nëndetësës 105. Gjatë aktivitetit në vijimësi është zhvilluar dhe ngjitje në malin e Sevasterit.

Kapitenët James Hilton dhe David Millner në Komandën Mbështetëse

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega, priti më 12 maj, në një takim kortezie atasheun ushtarak të SHBA në Tiranë, kapiten i rangut I James Hilton, i cili shoqërohej nga zëvendësuesi i tij në këtë detyrë, atasheu i ri ushtarak i SHBA-së kapiten i rangut II, David Millner. Kolonel Gega duke ju shprehur mirëseardhjen në Komandën Mbështetëse, ju uroi atyre njëkohësisht suksese në detyrat e radhës. Gjatë takimit ushtarakë e dy vendeve evidentuan fushat më të rëndësishme të bashkëpunimit ushtarak midis Komandës Mbështetëse dhe Forcat e Armatosura të SHBA, nga arsimimi dhe trajnimi i ushtarakëve shqiptarë në fushën e logjistikës, mbështetjen konkrete me materiale didaktike, teknike dhe gjithashtu stërvitjet e përbashkëta midis dy vendeve të zhvilluara ndër vite.

Zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse vlerësoi kontributin



e çmuar të kapiten të rangut I Hilton, gjatë qëndrimit të tij në detyrën e atasheut ushtarak amerikan në Shqipëri, për mbështetjen që ka dhënë në përgjithësi për Forcat tona të Armatosura dhe veçanërisht për Komandën Mbështetëse “Kapiten rangut I Hilton do të mbetet një mik i veçantë për ne, për kontributin e shkëlqyer që ai ka dhënë në forcimin e partneritetit strategjik e sidomos në fushën logjistike midis SHBA dhe Shqipërisë” - theksoi zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Gega. Nga ana e tij, kapiten rangut I Hilton vlerësoi arritjet e Komandës Mbështetëse bërë gjatë kësaj periudhe, ai vlerësoi bashkëpunimin me këtë komandë dhe theksoi se ndihej krenar që shërbeu në një vend me një histori të madhe dhe të çmuar sikurse Shqipëria. Ky bashkëpunim do të vazhdojë dhe shpresoj që kapiten i rangut II Millner të bëjë më shumë për forcimin e këtij bashkëpunimit. Më tej, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gega uroi atasheun e ri ushtarak të SHBA në Shqipëri, kapiten rangut II Millner për marrjen e detyrës së re dhe garantoj bashkëpunim të vazhdueshëm në fushën e logjistikës. Në fund të vizitës kolonel Gega i dhuroj kapiten rangut I Hilton stemën e Komandës Mbështetëse dhe sëbashku panë nga afër depon e materialeve të dhuruara nga pala amerikane.

Mesazh i SHSHPPFA në 63-vjetorin e Akademisë së Forcave të Armatosura

Akademia e Forcave të Armatosura, tribuna e mendimit të ri doktrinar ushtarak

Urim për pedagogët, instruktorët, drejtuesit dhe punonjësit civilë që kanë shërbyer dhe shërbejnë në Akademinë e Forcave të Armatosura

Mesazhi si më poshtë: “Ky 10 maj shënon 63-Vjetorin e Krijimit dhe Funksionimit të Akademisë së Forcave të Armatosura. Kjo është një kohë e gjatë me punë, përpjekje dhe kontribute të çmuara dhe të vlerësuara në shërbim të përgatitjes dhe arsimimit të oficerëve të Forcave të Armatosura, personelit të institucioneve të sigurisë së vendit dhe zhvillimit shkencor për çështjet e sistemit të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Ndaj sot, është ditë e veçantë të falënderoj dhe t’iu shpreh mirënjohjen e merituar të gjithë pedagogëve, instruktorëve, drejtuesve dhe punonjësve civilë, që kanë punuar e shërbyer me përkushtim ndër vite në këtë institucion.

Institucioni i Akademisë është reformuar, transformuar e zhvilluar ndër vite, gjithmonë me objektivin e qartë për të qenë tribuna e mendimit të ri doktrinar ushtarak dhe praktikave bashkëkohore të edukimit, arsimimit dhe trajnimit të Forcave të Armatosura. Unë jam besimplotë se Akademia e Forcave të Armatosura do të vazhdojë rrugën e suksesit duke konsoliduar vizionin e saj të ri që shpreh synimet, elementët dhe treguesit më cilësorë të filozofisë së re



të arsimimit ushtarak të integruar me arsimin e lartë kombëtar dhe me atë të vendeve të Aleancës.

Akademia e Forcave të Armatosura meriton dhe do të ketë gjithë vëmendjen dhe mbështetjen e veçantë për rritjen, përmirësimin dhe konsolidimin pedagogjik, akademik dhe programor për realizimin me sukses të misionit të saj edukativ, arsimor dhe shkencor. Gëzuar 63-Vjetorin e krijimit të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe suksese në misionin tuaj të rëndësishëm!”

Akademia e Forcave të Armatosura u krijua më 10 maj 1958, në Tiranë, në rajonin e Rrapit të Treshit, fillimisht me emërtimin Shkolla e Lartë Ushtarake.

Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit

Zhvillohet stërvitja planëzuese “Marqineti 21-01”

Në kuadër të programit akademik për vitin 2020-2021, gjatë katër ditëve nga data 26 prill deri më 30 prill 2021, në ambjentet e AFA-së, me kursantët e Kursit të Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH) u zhvillua stërvitja planëzuese “Marqineti 21-01”.

Objektivat kryesore të kësaj stërvitjeje ishin: Organizimi, funksionimi dhe koordinimi (BrMN-bk) sipas funksioneve për planëzimin e operacioneve luftarake, me synim rritjen e aftësive të tyre profesionale, bazuar në doktri-



nat Kombëtare dhe ato të Nato-s. Aplikimi i dijeve dhe njohurive teorike të marra në lidhje me zbatimin e Procesit të Vendimmarjes Ushtarake (MDMP), gjatë planëzimit të operacioneve luftarake në nivel batalioni. Stërvitja “Marqineti 21-01” u zhvillua duke shfrytëzuar doktrinat, manualët dhe formatet standarte si kombëtare po ashtu edhe ato të Nato-s, me qëllim aftësimin dhe përmirësimin e të gjithë elementëve të kryerjes së një operacioni luftarak. Gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të kësaj stërvitjeje u respektuan me rigorozitet të gjithë masat anti-COVID për mbrojtjen e personelit ndaj COVID-19. Në kuadër të programit akademik për vitin 2020-2021 me KTHOSH-in vazhdon stërvitja planëzuese “Marqineti 21-01”.



Qendra Stërvitore e Komandës Mbështetëse

7 kursantë përfundojnë Kursin EOD, niveli i III-të

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal) niveli i III-të. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse, kolonel Përparim Gega, pjesëtarë nga shtabi i Komandës Mbështetëse si dhe komandantët e strukturave të saj.

Në fjalën përshëndetëse zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Gega, falënderoi shtatë kursantët për rezultatet e arritura dhe instruktorët e tyre ndër të cilët ishin eksperte të Gardës së New Jersey. “Me ndihmën e këtyre kurseve kapaciteti EOD do të zhvillohet dhe rritet më shumë në të ardhmen për të kontribuar deri në nivel rajonal.” - u shpreh kolonel Gega.

Ky kurs shërben njëkohësisht edhe për zgjidhjen e detyrave të ndryshme EOD brenda dhe jashtë vendit si në operacione luftarake ashtu edhe në ato joluftarake. Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët. Në kurs morën pjesë 7 vetë, kryesisht nga Batalioni i Xhenios.

Në Komandën e Forcës Ajrore

Trajnim i personelit të Qendrës së Kontroll-Raportimit

Në Komandën e Forcës Ajrore prej disa ditësh u zhvillua trajnimi familjarizues me personelin operator për shërbimin e sigurinë e sistemit të radarit si dhe me personelin operator shërbimi radist e telefonist në Seksionin e Radarit. Qëllimi i këtij kursi ishte përcimi i informacionit të unifikuar mbi funksionimin bazë



të radarit, kontrollet rutinë si dhe rregullat e sigurisë gjatë operimit në radar. E veçanta e këtij trajnimi ishte ndërthurja e njohurive teorike me ato praktike, të cilat u transmetuan në mënyrë profesionale nga stafi teknik i Qendrës së Kontroll-Raportimit i Forcës Ajrore. Në fund të këtij trajnimi u krye një testim përfundimtar mbi njohuritë e marra nga personeli pjesëmarrës në kurs.

Libri i një gjenerali



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Një nismë që duhet nxitur...

Pas një pune të kujdesshme, këto ditë doli nga shtypi libri “Për artin ushtarak shqiptar”, me autor gjeneralmajor Spiro Shalësi, i përgatitur nga Bernard Zotaj dhe Arben Zvalani. Libri përmban histori ushtarake, studime, analiza dhe artikuj të ndryshëm të publikuar nga autori në vitet 1951-1974.

Nga studimet në bibliotekën e Akademisë së Forcave të Armatosura, përgatitësit ndeshën në mjaft shkrime dhe artikuj studimorë dhe problemorë, të shkruar në vite nga ushtaraku i lartë, i cili kishte studiuar në akademitë perëndimore, ishte përfshirë në luftë si antifashist dhe dalë malit partizan. Kështu u lindi mendimi për të mbledhur të gjithë këto shkrime që përbëjnë një pasuri për historinë ushtarake, por dhe për të njohur përvojën e kuadrove ushtarak në vite. Me nismën e tyre përgatitën këtë botim të thjeshtë, por me vlera njohësi, për punën dhe përpjekjet e ushtarakut shqiptar në vite.

Në bibliotekat tona gjenden mjaft shkrime të karakterit studimor dhe ushtarak të cilat na japin përpjekjet dhe punën e madhe të bërë nga ushtarakët në vite. Kjo përvojë dhe tërë ato sakrifica dhe përpjekje për organizimin, modernizimin dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura shqiptare në vite është e mira të njihen, të studiohen dhe të publikohen nga institucionet ushtarake. Institucionet ushtarake në mjaft tema studimore që përgatisin studentët në lëndë të veçanta, e mira do të ishte të trajtonin dhe mendimin teorik dhe praktik të kuadrove madhorë të ushtrisë, sipas armëve dhe shërbimeve të ndryshme, me qëllim për t'i bërë njohës të mendimit ushtarak shqiptar. Përvoja e këtyre kuadrove, mendimet dhe sugjerimet e dhëna për ushtrinë në kohë të ndryshme, bëjnë të kuptojmë mendimin, praktikën dhe nivelin e ushtrisë në periudha të ndryshme të kalimit të saj.

Këto nisma duhen nxitur nga institucionet ushtarake, por edhe nga pedagogët e kuadrot e FA-së, për të krijuar dhe mësuar për veprimtarinë e gjithanshme të mjaft kuadrove ushtarakë në vite, për t'u dhënë atyre vendin që iu takon, por dhe për qenë studimor në përvojën e tyre tepër të pasur dhe që është e shkruar në shtypin ushtarak të kohës.

Spiro Shalësi duhet të studiohet në fushën ushtarake

Dalëngadalë libri u konceptua dhe mori këtë përmbajtje. Në parathënie përgatitësit e librit e paraqesin Spiro Shalësin si njohës të mirë të artit ushtarak. Viti 1974 shënon fillimin e luftës kundër grupit të ashtuquajtur “puçist” në Ushtrinë Shqiptare. Spiro Shalësi, si shumë ushtarakë të lartë, përjashtohet nga Ushtria. Ai shpallet armik, sepse

kishte qenë pjesëtar në grupin e hartuesve të të ashtuquajturave “Teza të Zeza”. Për rrjedhojë, në dhjetor 1974 internohet.


Gjeneral Spiro Shalësi u largua nga ushtria në moshën e pjekurisë dhe të përvojës, por vetëm mund të themi fizikisht. Emri, lufta dhe sidomos puna e tij në vitet e shndërrimit të Ushtrisë shqiptare në një ushtri të rregullt, me një pamje bashkohore në organizim dhe në drejtim, e sidomos në përpunimin e mendimit teorik ushtarak shqiptar ka mbetur në kujtesën e ushtarakëve shqiptarë bashkëkohës, por dhe të brezave të tjerë pasardhës. Vepra e tij ngadalë po nxirret në dritë për t'u bërë e njohur me të gjithë tërësinë dhe veçorinë e saj.

Spiro Shalësi duhet të studiohet në fushën e karrierës ushtarake, në fushën organizative e drejtues të njërive të mëdha të Ushtrisë shqiptare, si dhe në punën e ndihmesës e dhënë prej tij në fushën studimore për të çuar më përpara mendimin ushtarak shqiptar.

Në kreun e parë me objekt “Shkrime për artin ushtarak shqiptar”, zënë vend shkrimet “Luftimi në afërsitë e katundit Arrëzë të Devollit”, “Manovrimi i shpejtë dhe goditja në befasi e armikut”, “Lufta e Leskovikut, një aksion i guximshëm”, “Luftimet u zhvilluan të kombinuara”, “Dalja nga rrethimi dhe hedhja në kundërsulm”, “Mësymje e rrufeshme, manovër e guximshme”, “Kalimi në mësymjen e përgjithshme të Ushtrisë Nacionalçlirimtare në pranverën e vitit 1944”.

Në kreun e dytë me objekt “Studime në ndihmë të artit ushtarak” trajtohen problemet: “Planëzimi dhe organizimi në drejtimin e stërvitjes të reparteve xheniere”, “Përgatitja fushore, baza e gatishmërisë luftarake të nënreparteve dhe reparteve xheniere” dhe “Shokë e vëllezër të një pozicioni”.

Në kreun e tretë me objekt “Shkrime të tjera” trajtohen problemet “Në roje të punës paqësore të popullit tonë” dhe “Për përgatitjen e mëtejshme speciale të oficerëve të xhenios”. Ndërsa në mbyllje përgatitësit kanë shkruar: gjeneralmajor Spiro Shalësi, njohës i artit, shkencës ushtarake dhe doktrinave të ushtrive.



Studime dhe përgjithësimet në fushën e mendimit ushtarak shqiptar

Spiro Shalësi edhe sot përfaqëson ushtarakun shqiptar të shkolluar, i cili e shihte karrierën të lidhur me studimin e paprerë që të shpinte në kryerjen e detyrave sa më mirë dhe në përputhje me interesat e Ushtrisë dhe të mbrojtjes të Atdheut. Ky përkushtim të shtyn përpara dhe në karrierë ushtarake. Këtë dukuri të tij e dëshmojnë mjaft mirë shkollat dhe akademitë e shumta ushtarake në të cilat u formua. Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare, përvoja organizative dhe drejtimi ushtarak i formacioneve luftarake në fushën e luftimit e më gjerë, e ngritën në rolin e drejtuesit ushtarak. Të tilla qenë batalionet që organizoi e drejtoi; shtabet e njërive të UNÇSH-së, në të cilat bëri pjesë si shtabi i Divizionit të Parë Sulmues. Bashkëpunimi në vijimësi me

ushtarakë të njohur dhe të aftë në karrierë, si Dali Ndreu dhe disa ndihmës të tjerë të tij, i dhanë vlera figurës së tij ushtarake. Këto vite të vështira të luftës i shërbyen Spiro Shalësit si shkollë e vërtetë e praktikës ushtarake në kushte të luftës jo aq klasike, por me veçori krejt shqiptare, sidomos në fushën organizative dhe të taktikës. Tashmë me njohuritë e gjera të fituara në akademinë ushtarake italiane, ndihmoi në ndërtimin dhe zbatimin e taktikave të luftës të formacioneve partizane që drejtonte në kohën e luftës kundër pushuesve fashistë italianë e gjermanë.

Me mundësinë që iu çel menjëherë pas Çlirimit të vendit, Spiro u kualifikua më tej në akademi ushtarake me emër, tashmë lindore, gjë që e aftësoi dhe e bëri atë një nga njohësit e zotëruesit më të mirë e të thelluar të artit ushtarak të të gjitha niveleve, si dhe të rolit të të gjitha armëve e shërbimeve në veprime të ndryshme luftarake. Njëkohësisht njohja e artit ushtarak dhe e doktrinave

të ushtrisë të disa vendeve të huaja, italiane, greke, ruse etj., si dhe kryerja e detyrave të nivelit të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes, në njësitë e mëdha si korpusi e deri në Institutin e Studimeve Shkencore të Ushtrisë, mundësuan që të bëhej një nga studiuesit e zellshëm të Artit Ushtarak Shqiptar. Këtë përvojë dhe art e pasqyroj mjaft mirë në një varg me studime dhe përgjithësime në fushën e mendimit ushtarak shqiptar. Përvojën e luftës dhe të stërvitjeve të Ushtrisë Shqiptare ai e pasqyroj jo vetëm thjesht përmes përshkrimeve të qarta e të sakta, por dhe duke e përpunuar dhe ngritur në trajtën e përgjithësimeve. Mendimi i tij ishte i përpunuar e i thelluar, i shtruar dhe i shkruar me shumë kulturë.

Analizat dhe studimet e tij gjenden kudo, në çdo stërvitje, me komandat dhe shtabet, me trupat, duke parashikuar dhe përpunuar situata dhe ide të shumta që i vinin ushtarakët në rrethana të ngjashme apo të përafërta me ato të luftës. Me aftësitë profesionale, me njohuritë e thella ushtarake të çdo lloji, me fantazinë dhe shpirtin e pasur krijues, si dhe me kulturën e gjerë, Gjeneral Shalësi ka dhënë një ndihmesë të pazëvendësueshme në përsosjen e vazhdueshme organizative, në përgatitjen luftarake të Ushtrisë shqiptare dhe në forcimin e mbrojtjes së Shqipërisë.

Në vitet e fundit të jetës e të punës së tij ushtarake, kohë kur gjenerali drejtonte dhe punonte në Institutin e Studimeve Ushtarake, ka hedhur në letër mendimin dhe përvojën e tij ushtarake, të pasur dhe të shquar. Gjenerali u përpoq që të krijonte një shkollë studimi dhe përpunimi të mendimit ushtarak shqiptar, për të përgatitur ushtarakë studioz, të apasionuar e të kulturuar. Nismë kjo që u ndërpre në mes. Kjo ka qenë dhe periudha më e vështirë e jetës së tij. Gjenerali përgatiti dhe shkroi disa punime, midis tyre dhe materialin studimor të emërtuar “Tezat e Zeza”. Ky ishte materiali i tij i fundit, sepse pas këtij ai u gjykua si “puçist”. Bashkë me disa gjeneralë të tjerë të shquar dhe oficerë madhorë u përjashtua nga Ushtria dhe u internuan.

Në vitet ‘60-70-të të shek. XX, kur shkruhej në fushën e teorisë dhe të mendimit ushtarak, duhet të kontrollohej nga partia. Kjo punë kërkonte guxim dhe ky guxim Spiro Shalësin nuk i mungonte, që ishte cilësi e karakterit të tij. Fundi i gjeneral Shalësit ishte dënim politik. Gjenerali ishte një ushtarak i shkolluar, njeri i kulturuar, komunikues dhe i dashur, i qeshur dhe i ndjeshëm, luftëtar i njohur i luftës për çlirim, drejtues i shquar i formacioneve të mëdha të Ushtrisë Shqiptare, studiues i talentuar dhe njohës i thellë i artit ushtarak. Punimet e tij po pasqyrohen në këtë përmbledhje të thjeshtë, por që kanë vlera. Kështu u punua dhe u përgatit ky libër për të njohur dhe vlerësuar kontributin e dhënë për ushtrinë nga gjeneral Spiro Shalësi.

5 maji "Dita e Dëshmorëve të Atdheut"

Kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut

Forca e Armatosur, nderon me përulësi dhe mirënjohjen më të thellë kombëtare të gjithë dëshmorët që bënë sakrificën sublime dhe dhanë jetën për Shqipërinë

Më 5 maj, në Ditën e Dëshmorëve, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj vendosën kurora me lule në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut. Një kurorë të veçantë ministri i Mbrojtjes dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm vendosën për Dëshmorët e Aviacionit Ushtarak Shqiptar.

Zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj dhe përfaqësues nga personeli i Forcës Ajrore dhe Baza Ajrore Farkë vendosën karafila të kuq mbi varrin e çdo dëshmorit të Aviacionit Ushtarak. Në ceremoninë përkujtimore morën pjesë familjarët, të afërm të Dëshmorëve të Aviacionit Ushtarak si dhe përfaqësues të Shoqatës së Aviacionit Ushtarak Shqiptar, të cilët vendosën tufa me lule. Pas vendosjes së kurorave ministri i Mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm dhe zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore takuan familjarët e dëshmorëve dhe ju shprehën atyre mirënjohjen dhe nderimin më të thellë që populli shqiptar dhe Forcat e Armatosura kanë për veprën dhe sakrificën e bërë nga Dëshmorët e Atdheut duke theksuar se ata janë kurdhoerë në mendjen dhe zemrën e çdo shqiptari, janë nderi dhe krenaria jonë.

Me rastin e 5 majit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, me anë të një mesazhi përkujton jetën dhe veprën e Dëshmorëve të Atdheut që dhanë jetën



për Shqipërinë. "Sot është dita e kujtimit të përjetësisë, lavdisë dhe veprës së pavdekshme të Dëshmorëve të Atdheut. Në këtë ditë, Forca e Armatosur, nderon me përulësi dhe mirënjohjen më të thellë kombëtare të gjithë dëshmorët që bënë sakrificën sublime dhe dhanë jetën për Shqipërinë. Në këtë ditë përkujtimi, ne të gjithë i detyrohemi një homazh mirënjohje të gjithë ushtarakëve dëshmorë, që me aktin dhe vetëmohimin e tyre, i kanë dhënë dhe i japin nder, dinjitet dhe krenari Forcave të Armatosura dhe vendit. Gjithë nderimet për heronjtë tanë dhe respekt pa fund për familjarët dhe pasardhësit e tyre. Lavdi jetës dhe veprës së tyre. I paharruar kujtimi i Dëshmorëve të Atdheut!", shkruan në mesazhin e tij Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, Gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj

Dy vite nga rënia në krye të detyrës e major Tanushit dhe nëntetare Hasanaj

Dëshmorëte Atdheut major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj ranë në krye të detyrës gjatë misionit të NATO-s në Letoni

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor Bajram Begaj, më 6 maj 2021, me anë të një mesazhi, ka përkujtuar dy vjetorin e rënies në krye të detyrës në misionin e NATO-s në Letoni të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushit dhe nëntetare Zarife Hasanaj.

Mesazhi si më poshtë: "Sot është përvjetori i dytë i rënies në krye të detyrës gjatë misionit të NATO-s në Letoni, të Dëshmorëve të Atdheut major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj. U bën dy vjet që jemi ndarë. Forca e Armatosur humbi dy nga efektivet e saj më të mirë, që kishin përpara një karrierë, një jetë. Kjo është një ditë e ndjerë dhe e vështirë për shokët, kolegët dhe bashkëpunëtorët, për gjithë Forcat e Armatosura, por është veçanërisht e vështirë dhe e dhimbshme për njerëzit e tyre të dashur, prindërit, fëmijët, familjet, motrat e vëllezërit dhe gjithë miqtë e të afërmit. Sot ne i bashkohemi dhimbjes së familjeve Tanushi e Hasanaj, për të kujtuar me nderim dhe respekt veprën dhe ndarjen nga jeta të këtyre bijve të pazëvendësueshëm, të ushtarakëve dhe heronjve të Shqipërisë. Ju, familjarë



të nderuar, asnjëherë nuk do jeni vetëm. Ne do të jemi gjithmonë me ju, gjithmonë bashkë. Në këtë ditë përkujtimi, ne të gjithë reflektojmë mbi sakrificat e këtyre dëshmorëve tanë, për aktet e guximshme dhe vetëmohimin, që i japin nder, dinjitet dhe krenari Forcave të Armatosura, vendit dhe Aleancës së madhe ku ne bëjmë pjesë. Ata na kujtojnë të gjithëve se profesioni i ushtarakut, kërkon të rinj dhe të reja, burra dhe gra me ndjenjën e përkushtimit, vetëmohimit dhe sakrificës. Rënia në krye të detyrës e Klodianit dhe

Zarifes, është dëshmi e gjallë e përkushtimit dhe sakrificës të Forcave tona të Armatosura në çdo angazhim dhe mision të NATO-s, në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit. Ata na kujtojnë se ne të gjithë iu detyrohemi atyre një homazh

mirënjohje, por iu detyrohemi edhe modernizimin e shërbimit të tyre dhe gjithë Forcave të Armatosura. Sakrifika sublime e tyre nuk do të harrohet. Ajo është pjesë e motivimit të përditshëm të të gjithë vajzave, grave dhe burrave në uniformë, të cilët të heshtur dhe pa zhurmë, janë çdo ditë, brenda dhe jashtë vendit, të gatshëm dhe në shërbim të nevojave dhe detyrimeve kombëtare dhe euroatlantike. I paharruar qoftë kujtimi i Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj!"

Major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj

Ranë në krye të detyrës në Camp Adazi, Letoni

Në Batalionin e Xhenios të Komandës Mbështetëse u zhvillua më 6 maj ceremonia përkujtimore e rënies në detyrë të Dëshmorëve të Atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj. Në këtë ceremoni ishte e pranishme zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Manushaqe Shehu, zëvendëskomandanti i Komandës Mbështetëse kolonel Përparim Gega dhe familjarët e dëshmorëve. Fjalën e mori fillimisht komandanti i Batalionit të Xhenios (bXh), kolonel Hajdar Gurra, i cili duke iu drejtuar të pranishmëve theksoi sakrificën sublime, atë të dhënies së jetës së dy dëshmorëve Tanushi dhe Hasanaj në krye të detyrës, si shembull i sakrificës, dinjitetit dhe përkushtimit, duke mos kursyer as veten, për një botë të pastër pa mina. Më pas fjalën e mori zëvendës shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneral brigade Manushaqe Shehu, e cila duke përcjellë edhe përshëndetjet e veçanta të ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu mirënjohjen për aktin sublim të dëshmorëve rënë në Letoni

dy vite më parë. "Ata sot nuk gjenden më fizikisht midis nesh, por mbeten pjesë e jona, e historisë dhe lavdisë së Forcave të Armatosura; simbol i përgjegjësisë, gatishmërisë e përkushtimit për kryerjen e misionit dhe detyrës fisnike të ushtarakut në emër të atdheut dhe Shqipërisë. Emri i tyre nderohet në Aleancë, rënia e tyre përkujtohet sot nga kolegët e NATO-s. Rënia e Klodianit dhe Zarifes në krye të detyrës, është dëshmi e gjallë e përkushtimit dhe sakrificës të Forcave tona të Armatosura në çdo angazhim dhe mision të NATO-s, në shërbim të qytetarëve dhe sigurisë së vendit dhe asaj globale"-u shpreh ajo. Ky është përvjetori i dytë i rënies në detyrë të dëshmorëve më të rinj të atdheut, major Klodian Tanushi dhe nëntetare Zarife Hasanaj, të cilët janë përkujtuar përmes një ceremonie edhe në Letoni. Emrat e tyre janë gdhendur tashmë me germa të arta në historinë e Forcave të Armatosura e njëkohësisht dhe vendit tonë e do të kujtohen përjetë.



Qendra e Personel Rekrutimit

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë 1 (një) kandidat për të ndjekur “Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Detare”, i cili do të zhvillohet në Akademinë Mbretërore të Forcës Detare në Dartmouth, në Britaninë e Madhe, në periudhën 06 shtator 2021-12 gusht 2022. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 19 maj 2021.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në ndjekje penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më shumë se 27 vjeç, në momentin e titullimit (13 gusht 2022, sipas ligjit nr. 59/2014, “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura). Të jetë ushtarak/civil (rekrut, ushtar, nën-officer dhe nëntogeri ril cili nuk ka kryer kursin bazë të oficerit, ose kursant që është duke ndjekur Kursin e Përgatitjes së Oficerit të Ri), i cili ka përfunduar minimumi studimet “bachelor”, brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë. Të ketë kryer shkollën e lartë (minimumi “bachelor”) ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të lartë. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe listën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të lartë (bachelor), jo më pak se 7 (shtatë). Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 71 pikë në testimin ALCPT ose nivelin 2/2/2/2 sipas STANAG 6001. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të ketë aftësi për të notuar deri 100 m. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, të sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë akademive ushtarake jashtë vendit, me qëllim pranimit në akademi. Të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose vendore (nëse ka qenë i punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi. Kjo kërkesë aplikohet për kandidatët që nuk janë pjesë e FA-së. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët që rekrutohen nga radhët e Forcave të Armatosura përveç kritereve të mësipërme duhet të plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme: të kenë vlerësimin e punës jo më pak se “shumë mirë”; të mos kenë asnjë masë

Kërkohet 1 (një) kandidat për Akademinë Mbretërore të Forcës Detare, në Britaninë e Madhe

“Kursi i titullimit të Oficerit të Forcës Detare” për periudhën 06 shtator 2021-12 gusht 2022. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 19 maj 2021



Vërtetim nga përmbartimi. Ekzaminimet për agentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Aplikanti do të kalojë katër testime në datat e përcaktuara. Datat e testimit janë: Testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 20.05.2021. Testi fizik do të zhvillohet më 20.05.2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 21.05.2021 kurse testi psikologjik do të zhvillohet më 21.05.2021.

Shënim: Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e

disiplinore në fuqi.

Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s’kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit, Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve ushtarake në “Kursin e titullimit të Oficerit të Forcës Detare”, që do të zhvillohet në Britaninë e Madhe. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, ANEKSI A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit të lartë (minimumi bachelor) së bashku me listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografia për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport i aftësisë në punë të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore së vendbanimit, i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohej se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agentët infektivë (Hepatit B, C dhe D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bankat e gjakut apo drejtoritë e



Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit që plotësohen në momentin e aplikimit pranë zyrës së pranimit në Qendrën e Personel

Rekrutimit, për gjendjen shëndetësore dhe për procedim penal ose jo, si dhe është ose jo i dënuar. Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar brenda 10 ditëve pas përfundimit të testimit: Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata. Vërtetim nga prokuroria.

plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

Kolegji Detar Mbretëror Britannia (BRNC), i njohur zakonisht si Dartmouth, është akademia detare e Mbretërisë së Bashkuar dhe krijimi fillestar i trajnimit të oficerëve të Marinës Mbretërore. Ndodhet në një kodër me pamje nga porti i Dartmouth, Devon, Angli. Trajnimi i oficerëve të marinës mbretërore është zhvilluar në Dartmouth që nga viti 1863. Ndërtesat e kampusit aktual u përfunduan në 1905. Më herët studentët jetonin në dy godina druri të ankoruara në lumin Dart. Që nga viti 1998, BRNC ka qenë qendra e vetme për trajnimin e oficerëve të Marinës Mbretërore.



QPR rekruton kandidatë për studime

Pesë (5) kandidatë për studime në shkollat e larta ushtarake të Greqisë

*Tre bursa për mjekësi, një për oficer tokësor dhe një për oficer detar.
Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri më 21 qershor 2021*

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale. Të mos jetë në proces gjykim penal nga gjykata. Të mos ketë probleme me deportimin. Të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe alkolit, për të cilat do të paraqesin testet e kryera. Të mos jetë person i dyshuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundërligjshme apo kriminale. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të ketë kryer shkollën e mesme ose të jetë në vitin e fundit të saj. Në momentin e aplikimit kandidati duhet të paraqesë dokumentat e përfundimit të arsimit të mesëm. Kandidatët që janë duke ndjekur studimet në vitin e fundit duhet të paraqesin një vërtetim mbi rezultatet e dy viteve të para. Në përfundim të studimeve duhet të paraqesin diplomën dhe certifikatën e notave. Të ketë notën mesatare të lëndëve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm, jo më pak se 7 (shtatë). Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe jo më pak se 160 cm për femrat. Të mos jetë i martuar. Kandidatët duhet të zotërojnë gjuhën angleze, mbi 60 pikë në testimin ALCPT. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme); të mos ketë kaluar apo të vuajë nga sëmundje të zemrës, veshkave, hepatite, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose të jetë përdorues i lëndëve narkotike. Të rezultojë kalues në testet fizike, shëndetësore, intelektuale, gjuhësore ose trajnuese, që zhvillohen nga vendet partnere në vendin tonë ose pranë shkollave ushtarake jashtë vendit, me qëllim



pranimin në shkollat ushtarake. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen si dhe të ketë bërë të gjitha vaksinat dhe të mos jetë mbartës i sëmundjeve ngjitëse. Të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit. Të plotësojë kushtin e sigurisë. Të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor në Njësinë Mjekësore Ushtarake. Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: kanë kryer më parë të njëjtin nivel arsimor ushtarak brenda ose jashtë vendit, kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e



studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar ato, kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më

sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë, dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve në Shkollat e Larta Ushtarake të Greqisë dhe preferenca e degës për të cilën aplikohet. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografi për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shën-

detësore të vendbanimit i shoqëruar edhe me një raport shpjegues, ku deklarohet se kandidati është i shëndetshëm, nuk ka sëmundje kronike, infektive, të shëndetit mendor në anamnezën e tij personale dhe nuk është përdorues i lëndëve narkotike. Ekzaminimet mjekësore për agentë infektiv (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz), grupin e gjakut dhe lëndët narkotike, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në prefekturat apo rrethet ku banojnë, si dhe testet për lëndët narkotike nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve:

Kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 10 ditëve duhet të paraqesin dëshmi penaliteti, vërtetim nga gjykata, vërtetim nga prokuroria, vërtetim nga përmbartimi, ekzaminimet për agentët infektivë (Hepatit B, Hepatit C, Hepatit D, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe raportin mjekësor të lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor, në Njësinë Mjekësore Ushtarake por edhe testet për lëndët narkotike të lëshuar nga laboratorë të certifikuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Datat e testimit:

Ndërsa aplikanti do të kalojë katër teste në datat e përcaktuara. Kështu testi i gjuhës së huaj (anglisht) do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi fizik do të zhvillohet më 23 qershor 2021. Testi intelektual do të zhvillohet më 24 qershor 2021 dhe testi psikologjik do të zhvillohet më 24 qershor 2021.

Shënim: Aplikanti duhet të deklarojë se të dhënat e paraqitura në formularët e plotësuar janë të vërteta dhe ai autorizon kontrollin e vërtetësisë së tyre nga subjekti i autorizuar. Trajtimi i të dhënave personale do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe passjell përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.



Jens Stoltenberg u dergon mesazh shumë të qartë Talibanëve

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha më 6 maj 2021, se NATO vazhdon të monitorojë nga afër vendosjen e rëndësishme ushtarake të Rusisë në dhe rreth Ukrainës. Duke folur në një takim të ministrave të Mbrojtjes të Bashkimit Evropian, Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti njoftimin e BE-së për të përfshirë Kanadanë, Norvegjinë dhe Shtetet e Bashkuara në projektet PESCO mbi lëvizjen ushtarake, duke u mundësuar trupave të lëvizin më shpejt në të gjithë Evropën. “Aleatët e jo-BE-së luajnë një rol thelbësor në sigurinë dhe mbrojtjen e Evropës”, tha Z. Stoltenberg. Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu tha se Rusia kishte tërhequr disa trupa nga kufiri i Ukrainës por që dhjetëra mijëra të tjera ende mbeten në rajon. “Në përgjithësi, ekziston një prani e rëndësishme ruse dhe ka shumë më tepër trupa ruse tani, brenda dhe rreth Ukrainës, sesa para rritjes së fundit të tensioneve”, tha ai.

Për Afganistanin, Sekretari i Përgjithshëm tha se tërheqja e misionit të Stërviçes së Vendosur të NATO-s ishte në proces, por që fundi i misionit të NATO-s nuk do të thotë fundi i marrëdhënies së Aleancës me Afganistanin. Aleatët po shikojnë se si ata mund të vazhdojnë të sigurojnë mbështetje financiare dhe trajnuese për forcat Afgane, tha Sekretari i Përgjithshëm.

“Unë pres që të takohem me ministrat e Mbrojtjes të BE dhe Përfaqësuesin e Lartë Borrell. Më lejoni së pari, të mirëpresim vendimin për përfshirjen e Kanadasë, Norvegjisë dhe Shteteve të Bashkuara në projektin PESCO për lëvizjen ushtarake. Aleatët jo-BE luajnë një rol thelbësor në mbrojtjen dhe mbrojtjen e Evropës, tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg në një deklaratë pas mbërritjes në Këshillin Evropian. “Ne po vendosim mijëra trupa si pjesë e një stërviçe të NATO-s dhe e bëjmë atë në Rumani. Dhe kjo tregon se si ne mobilizojmë dhe ushtrime trupat e NATO-s, dhe gjithashtu se si jemi në

Çdo sulm ndaj trupave të NATO-s do ketë një përgjigje të fuqishme

Tërheqja e trupave të NATO-s, apo fundi i Misionit të Mbështetjes së Vendosur, nuk është fundi i partneritetit tonë me Afganistanin



gjendje t'i vendosim ato në të gjithë Evropën. Si pjesë e këtij ushtrimi, ka ushtarë nga Mbretëria e Bashkuar, nga Shtetet e Bashkuara, nga Turqia, kështu që tregon gjithashtu rëndësinë e lëvizjes së trupave të NATO-s shpejt nëpër Evropë dhe kjo është gjithashtu një arsye pse lëvizja

ushtarake është kaq e rëndësishme. Ne gjithashtu do të diskutojmë Rusinë dhe modelin e sjelljes agresive ruse, nga operacionet e rrezikshme të inteligjencës në Bullgari, Republikën Çeke, por edhe ndërtimin e konsiderueshëm ushtarak në dhe rreth Ukrainës.

Ne kemi parë një farë reduktimi në numrin e trupave ruse, por dhjetëra mijëra mbeten, dhe ne gjithashtu po shohim se Rusia ka mbajtur shumë armë, aparatura dhe pajisje, dhe ata gjithashtu po vendosin kufizime në Detin e Zi, përfshirë kufizimin e hyrjes deri në De-

tin e Azov përmes ngushticës së Kerçit, dhe për këtë arsye NATO ka nevojë të qëndrojë vigjilente dhe të monitorojë nga afër zhvillimet. Në përgjithësi, ekziston një prani e rëndësishme ruse dhe ka shumë më tepër trupa ruse tani, brenda dhe rreth Ukrainës, sesa para rritjes së fundit të tensioneve.

Ne gjithashtu do të diskutojmë Afganistanin, unë do t'i azhurnoj ministrat mbi vendimin e NATO-s për t'i dhënë fund Misionit tonë të Mbështetjes së Vendosur në Afganistan dhe tërheqja e trupave tani është duke u zhvilluar. Ne u kemi dërguar një mesazh shumë të qartë Talibanëve, se çdo sulm ndaj trupave të NATO-s do të pritët me një përgjigje të fuqishme. Tërheqja e trupave të NATO-s, fundi i Misionit të Mbështetjes së Vendosur, nuk është fundi i partneritetit tonë me Afganistanin, në të vërtetë po hap një kapitull të ri dhe ne tani po shikojmë se si mund të vazhdojmë të ofrojmë mbështetje. Ne jemi duke kërkuar mënyra për të siguruar mbështetje financiare, ndihmë me trajnime dhe gjithashtu të mbështesim bashkësinë ndërkombëtare në Afganistan. NATO ka mbështetur fuqimisht procesin e paqes dhe një zgjidhje paqësore e negociuar e konfliktit në Afganistan është mënyra më e mirë për të ruajtur arritjet që kemi bërë së bashku, gjatë dekadave të fundit.”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg

Solidaritet transatlantik jo vetëm me fjalë, por me vepra

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në një takim, me Shefat e Shteteve dhe Qeverive të Nismës “Bukureshti 9 (B-9) 2021”, më 10 maj 2021, e cila përfshin Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Letoninë, Lituaninë, Poloninë, Rumaninë dhe Sllovakinë.

“Samiti i NATO-s muajin tjetër na ofron një mundësi unike për të filluar një kapitull të ri në marrëdhëniet transatlantike për të forcuar unitetin midis Evropës dhe Amerikës së Veriut dhe për të përgatitur Aleancën tonë për sfidat e sotme dhe të nesërme,” tha Sekretari i Përgjithshëm, Stoltenberg. “Në një botë më të paparashikueshme dhe konkurruese, ne duhet të bëjmë më shumë së bashku dhe të demonstrojmë solidaritet transatlantik jo vetëm me fjalë, por me vepra. Pra, në Samit, ne do të kemi një agjendë ambicioze dhe të ardhme, forcimin e angazhimit



tonë për të mbrojtur njëri-tjetrin, duke zgjeruar qasjen tonë ndaj sigurisë dhe duke marrë një qasje më globale, për të mbrojtur rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla. Ky takim sot është një mundësi e rëndësishme për të çuar përpara këtë axhendë.”

Iniciativa “Bukureshti 9 (B-9) 2021”, e ka nisjen e vet nga Polonia dhe Rumania në 2014 nga Presidentët e 9 vendeve. Qëllimi i saj është të konsolidojë pikëpamjet mbi çështjet me interes në Aleancë për kombet pjesëmarrëse dhe të mbështesë projekte të përbashkëta sigurie.

10 vjetori i marrëveshjes kryesore të mbrojtjes nga raketat

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s: Raketat mbeten një armë e zgjedhur për kundërshtarët e mundshëm

NATO më 12 maj 2021 shënoi 10 vjetorin e marrëveshjes midis Rumanisë dhe Shteteve të Bashkuara për të krijuar sistemin e mbrojtjes nga raketat balistike me bazë tokësore në Rumaninë jugore. Duke iu drejtuar zyrtarëve të lartë në Senatin Rumun përmes video-lidhjes, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoană falenderoi Rumaninë për pritjen e faqes së mbrojtjes raketore “Aegis Ashore” në qytetin Deveselu, që siguron mbrojtje 24/7 kundër raketave balistike nga jashtë zonës Euro-Atlantike. Ndërtuar dhe operuar nga Shtetet e Bashkuara në emër të NATO-s, baza e mbrojtjes nga raketat bën pjesë në një mburojë raketore më të madhe evropiane të NATO-s, e cila gjithashtu përfshin radarë dhe anije në të gjithë Evropën.

Në Samitin e Lisbonës të NATO-s në 2010, aleatët vendosën të zhvillojnë një aftësi për të mbrojtur anëtarët evropianë të NATO-s nga kërcënimet e raketave balistike nga jashtë zonës Euro-Atlantike. Aftësia fillestare operacionale u arrit në 2016. Z. Geoană theksoi se puna e NATO-s për mbrojtjen nga raketat vazhdon, pasi raketat mbeten një armë e zgjedhur për kundërshtarët e mundshëm. Ai theksoi se mbrojtja raketore luan një rol jetësor për parandalimin e NATO-s dhe është theksht mbrojtëse. Duke pritur Samitin e Brukselit në qershor, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm nënvizoi se takimi do të jetë një mundësi unike për të forcuar NATO-n si mishërimi i përhershëm i lidhjes midis Evropës dhe Amerikës së Veriut.



Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Mircea Geoană, duke folur në Simpoziumin e Lëvizjes Ushtarake të organizuar më 6 maj 2021, nga Agjencia Evropiane e Mbrojtjes dhe Presidenca Portugeze e Këshillit Evropian, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të fortë NATO-BE për lëvizjen ushtarake për të ruajtur gatishmërinë dhe sigurinë kolektive.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm tha se lëvizja ushtarake ishte thelbësore për parandalimin dhe qëndrimin e mbrojtjes së NATO-s. Ai tha se aftësia e NATO-s për të lëvizur me shpejtësi forcat dhe pajisjet përtej Atlantikut dhe përtej kufijve evropianë mbështet aftësinë e Aleancës për të ruajtur paqen dhe sigurinë. Vendosija e shpejtë në të gjithë Evropën kërkon jo vetëm ushtrinë por një qasje të të gjithë qeverisë, shtoi ai, duke përfshirë sektorin tregtar dhe aktorët civilë dhe ushtarakë. Z. Geoană tha se “rritja e lëvizshmërisë ushtarake ka rëndësi jo vetëm për vendosjen e shpejtë të forcave dhe forcimin në kohë të aleatëve, por gjithashtu për të qenë në gjendje të mbash forcat në operacione, trajnime dhe stërvitje”.

Duke parë në të ardhmen, z. Geoană nënvizoi se “për të përmirësuar më tej lëvizjen ushtarake,

NATO dhe BE duhet të ndjekin qasje koherente dhe sinergji



NATO dhe BE duhet të vazhdojnë të ndjekin qasje koherente dhe sinergji”. Këto fusha të përmirësimit, tha ai, përfshijnë rregulloret për kalimin e shpejtë të kufirit, koordinimin e ngushtë midis forcave ushtarake dhe organeve të qeverisë civile, qasjen në aftësitë e nevojshme të transportit dhe sigurimin që infrastruktura kombëtare e transportit të jetë e përshtatshme për qëllimin.

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm gjithashtu mirëpriti vendimin e BE-së për të miratuar kërkesat nga Kanadaja, Norvegjia dhe Shtetet e Bashkuara për t'u bashkuar me projektin PESCO mbi lëvizjen ushtarake, duke thënë se “Aleatët e jo-BE-së japin një kontribut të rëndësishëm në mbrojtjen evropiane dhe për këtë arsye, përfshirja e tyre në Nismat e BE-së për mbrojtjen na japin përfitime të gjithëve.”

NATO-Austri: Marrëveshje mbi zyrën e ndërlidhjes në Vjenë

Më 10 maj 2021, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s priti ministrin Federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Alexander Schallenberg, në Selinë e NATO-s për diskutime në lidhje me partneritetin e fortë që ekziston midis Austrisë dhe Aleancës.

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg dhe ministri Federal për Çështjet Evropiane dhe Ndërkombëtare të Austrisë, Alexander Schallenberg nënshkruajnë një marrëveshje midis Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO) dhe Qeverisë Federale të Austrisë për statusin ligjor të Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s në Vjenë.

Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Austrinë për kontributin e saj në misionin e NATO-s në Afganistan. Z. Stoltenberg tha se vendimi për tërheqjen e forcave ndërkombëtare nga vendi nuk ishte i lehtë dhe përfshin rrezik, por që alternativa do të kishte qenë një angazhim i hapur ushtarak. Z. Stoltenberg shtoi se aleatët tani po shikojnë se si ata mund të vazhdojnë të mbështesin forcat afgane, përfshirë financimin dhe trajnimin.

Për Ballkanin Perëndimor, Sekretari i Përgjithshëm përsëriti se Aleanca mbetet e përkushtuar ndaj rajonit dhe ai falënderoi Austrinë për mbështetjen e saj të gjatë dhe thelbësore për misionin paqeruajtës të KFOR-it të NATO-s



dhe paqen në Ballkanin Perëndimor. Takimi dypalësh u pasua nga një ceremoni nënshkrimi e marrëveshjes midis NATO-s dhe Qeverisë Federale të Austrisë për statusin ligjor të Zyrës Ndërlidhëse të NATO-s në Vjenë. Pasi të jetë në fuqi, kjo marrëveshje do të hapë rrugën për krijimin zyrtar të Zyrës

Ndërlidhëse të NATO-s në OSBE dhe organizata të tjera ndërkombëtare në Vjenë. Gjatë ceremonisë, Sekretari i Përgjithshëm përshëndeti rolin e Austrisë në mbështetjen e lidhjeve të forta midis BE-së dhe NATO-s dhe në pritjen e Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE).


Danimarka ka marrë komandën e Misionit të NATO-s në Irak

Më 6 maj 2021, gjenerallejtnant Michael Lollesgaard i Forcave të Armatosura Daneze mori komandën e Misionit të NATO-s në Irak, pas një ceremonie të mbajtur në Bagdad. Ai pason gjeneral-lejtnant Per Olsen të Forcave të Armatosura daneze, i cili ishte në komanë të misionit që nga nëntori i vitit 2020.

“Falënderoj gjenerallejtnant Olsen për shërbimin e tij,” tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg. “E e mirëpres gjenerallejtnant Lollesgaard si komandantin e ri të misionit tonë, i uroj sukses gjatë mandatit të tij dhe shpresoj të punoj me të, pasi ne vazhdojmë përpjekjet tona për të kështilluar institucionet e sigurisë të Irakut dhe forcat e armatosura, siç kërkohet nga qeveria irakene.”

Misioni i NATO-s Irak, u nis në Samiti e NATO-s në Bruksel në korrik 2018, pas një kërkesë nga qeveria irakiane. Misioni është themeluar në Bagdad në tetor 2018. Është një mision këshillimor, trajnues dhe ndërtimi i kapaciteteve jo-luftarake që ndihmon Irakun në ndërtimin e institucioneve dhe forcave të armatosura më të qëndrueshme, transparente, gjithëpërfshirëse dhe efektive, në mënyrë që ato të jenë më të afta për të luftuar terrorizmin, parandalimin e kthimit të ISIS dhe stabilizimin e vendit.





“Defender-Europe 21” është stërvitje vjetore e përmasave të mëdha ushtarake amerikane në Europë dhe Afrikë, i përbashkët, shumëkombësh, i dizajnuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ndërmjet ushtrisë amerikane, NATO-s dhe partnerëve tjerë. Me këtë rast, ushtarët e FSK-së radhiten përkrah ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s nën udhëheqjen e partnerit strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



Pjesa kryesore e stërvitjes do të realizohet nga data 17 deri më 29 maj 2021

Kosova është pjesëmarrëse në stërvitjen “Defender-Europe 21”

Trupat e ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s do të zbarkojnë në Kosovë; mes tyre ushtarakë të ushtrisë Amerikane dhe pjesëtarë të forcave nga Komanda Europiane e SHBA-së



e Gjakovës, kurse Ushtrimi Fushor do të realizohet në Zonën e Trajnimit në “Baba i Bokës” në komunën e Gjakovës. Vendosi e kapaciteteve të këmbësorisë do t’a bëjë ekipi vlerësues i KDS në bashkëpunim me ekipin ushtarak amerikan të Brigadës të Ndihmës së Forcave të Sigurisë (Security Force Assistance Brigade-SFAB). Pjesa kryesore e ushtrimit do të realizohet nga data 17 deri 29 maj 2021. Për detajet e pjesëmarrjes së Kosovës në këtë ngjarje, Ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj së bashku me Komandantin e FSK-së Gjenerallejtënant Rrahman Rama kanë mbajtur konferencë për media, në Ministrinë e Mbrojtjes, më datë 6 maj, 2021.

Kosova për herë të parë është pjesëmarrëse në stërvitjen ushtarake më të madhe në rajon “Defender-Europe 21”. “Defender-Europe 21” është stërvitje vjetore e përmasave të mëdha ushtarake amerikane në Europë dhe Afrikë, i përbashkët, shumëkombësh, i dizajnuar për të ndërtuar gatishmërinë dhe ndërveprimin ndërmjet ushtrisë amerikane, NATO-s dhe partnerëve tjerë. Me këtë rast, ushtarët e FSK-së radhiten përkrah ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s nën udhëheqjen e partnerit strategjik Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kosova do të jetë gjithashtu në mesin e 16 vendeve pritëse, rrjedhimisht trupat e ushtrive të shteteve anëtare të NATO-s do të zbarkojnë në Kosovë, mes tyre ushtarakë të ushtrisë Amerikane dhe pjesëtarë të forcave nga Komanda Europiane e SHBA-së.

Komanda e Lartë (HICON) dhe Audienca Sekondare do të jenë të vendosur në Aeroportin

Turqia do të mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në

Në vazhden e takimeve me përfaqësuesit e korit diplomatik në Kosovë, ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, priti në takim ambasadorin e Republikës së Turqisë në Kosovë, Çagri Sakar. Me këtë rast, ambasadori Sakar, i përcolli ministrit Mehaj urimet e Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Turqisë Hulusi Akar. Duke e uruar personalisht për detyrën e ministrit, ambasadori Sakar i premtoi ministrit Mehaj se Turqia, si një vend mik dhe aleat i fuqishëm i Kosovës, do të vazhdojë ta mbështesë Ministrinë e Mbrojtjes dhe FSK-në, në të gjitha fushat dhe komponentët në mënyrë që t’i përmbushë me sukses të plotë synimet e saj.

Nga ana e tij, ministri Mehaj e falënderoi ambasadorin Sakar për vizitën e tij duke shprehur mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për Republikën e Turqisë, për ndihmën dhe mbështetjen



e ofruar në ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale ushtarake të FSK-së. Të dy u pajtuan që bashkëpunimi në nivel


të ministrive të mbrojtjes të fuqizohet edhe më tej në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit rajonal e më gjerë.

Ministri Mehaj priti ambasadorin e gjermanisë Joern Rohde

Ministri i Mbrojtjes Armend Mehaj, priti në takim, për herë të parë që nga Memërimi në detyrë, ambasadorin fuqiptotë të Republikës së Gjermanisë në Republikën e Kosovës, Joern Rohde. Me këtë rast, ambasadori Rohde duke i uruar detyrën ministrit Mehaj, konfirmoi qëndrimin e Gjermanisë për vazhdimin dhe thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit si dhe konkretizimin e aktiviteteve dhe shkëmbimeve të përvojave të përbashkëta në mes të Ministrisë së Mbrojtjes të Gjermanisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Kosovës. Nga ana e tij, ministri Mehaj shprehu falënderimin e tij për popullin dhe



Qeverinë e Gjermanisë për gjithë ndihmën e vazhdueshme që ka dhënë për Kosovën, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Forcën e Sigurisë së Kosovës. Të dy theksuan rëndësinë e fuqizimit të mëtejshëm të partneritetit bilateral dhe zgjerimit të fushave të interesit të përbashkët në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



“Maqedonia e Veriut punon shpejt në këtë fushë. Ne jemi anëtar i ri i NATO-s, gjë që na bën edhe më të motivuar të jemi një aleat i njohur që jep një kontribut të rëndësishëm në sigurinë e të tridhjetë vendeve. Zhvillimi i poligonit tonë më të madh ‘Krivollak’, i cili vlerësohet nga oficerët e lartë të NATO-s si një terren testimi që ofron kushte gjithëpërfshirëse për zhvillimin e interoperabilitetit, do të thotë zhvillimi i Aleancës.



Radmilla Shekerinska vizitë zyrtare në Romë

Maqedonia e Veriut-bashkëpunim me Italinë në fushën e mbrojtjes

Ministri italian Guerini: “Pranimi i Maqedonisë së Veriut në NATO është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së stabilitetit dhe sigurisë së të gjithë rajonit të Ballkanit”

Italia dhe Maqedonia e Veriut kanë një bashkëpunim të shkëlqyeshëm dypalësh të bazuar në një qëllim të përbashkët: një Ballkan të qëndrueshëm dhe prosperuar për një Europë të fortë. “Kontributi i Armatës maqedonase në KFOR në Kosovë, nën komandën e një gjenerali italian, forcoi më tej aleancën midis dy vendeve dhe kontribuon në sigurinë e zonës Euro-Atlantike” -u dakorduan më 6 maj 2021, në një takim në Romë ministrat e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska dhe homologu i saj italian Lorenzo Guerini.

Dëshmi e avancimit të marrëdhënieve të mbrojtjes është rinovimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim Mbrojtës midis Maqedonisë së Veriut dhe Italisë, me të cilën Marrëveshja fitoi vlefshmëri të pakufizuar.

Ministrja Shekerinska theksoi se pas anëtarësimit në NATO, Maqedonia e Veriut kontribuon në sigurinë kolektive të Aleancës.

“Maqedonia e Veriut punon shpejt në këtë fushë. Ne jemi anëtar i ri i NATO-s, gjë që na bën edhe më të motivuar të jemi një aleat i njohur që jep një kontribut të rëndësishëm në sigurinë e të tridhjetë vendeve. Zhvillimi i poligonit tonë më të madh ‘Krivollak’, i cili vlerësohet nga oficerët e lartë të NATO-s si një terren testimi që ofron kushte gjithëpërfshirëse për zhvillimin e interoperabilitetit, do të thotë zhvillimi i Aleancës.



“Armatë maqedonase ka filluar një proces të pajisimit dhe modernizimit, i cili mundësohet nga buxhetimi i qëndrueshëm i mbrojtjes, nga i cili nuk devijojmë,” -tha ministrja Shekerinska.

Ajo e informoi homologun e saj për vendimin e Armatës së Maqedonisë së Veriut për të dërguar një oficer shtabi në trupat italiane të deklaruara të NATO-s.

Ministri italian Guerini tha se pranimi i Maqedonisë së Veriut në NATO është një hap i rëndësishëm drejt rritjes së stabilitetit dhe sigurisë së të gjithë rajonit të Ballkanit. Ai shprehu mbështetje të fortë për fillimin e negociatave midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së dhe mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare sa më shpejt të jetë e mundur.

Ballkani duhet të jetë stabil, -ranë dakord Shekerinska dhe Guerini, ndërsa rindërtimi i perspektivës europiane është një hap i rëndësishëm për sigurinë e rajonit. Në Senatin Italian, ministrja Shekerinska gjithashtu u takua me Kryetaren e Komitetit të Mbrojtjes, Roberta Pinotti, për të diskutuar bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes. Pinotti i shprehu mbështetje të fortë ministres për fillimin e negociatave midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së.

Maqedonia e Veriut dhe Italia kanë bashkëpunuar në fushën e

mbrojtjes që nga viti 1997 në fushën e bashkëpunimit civilo-ushtarak, logjistikës, forcave ajrore, trajnimit dhe arsimit. Deri më tani, në disa nga trajnimet dhe shkollimet në Itali kanë qenë kadetë të Akademisë Ushtarake, si dhe oficerë nga Armatë e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Të dy vendet bashkëpunojnë gjithashtu në nivel rajonal, në kuadër të iniciativës SEDM, dhe bashkëpunimi brenda misionëve ndërkombëtarë është intensive-në kontingjentin italian në UNIFIL në Liban, si dhe në forcën e KFOR-it në Kosovë, të udhëhequr nga gjenerali italian Franco Federici, ku ushtria maqedonase merr pjesë me 44 pjesëtarë të Armatës. Gjatë vizitës, ministrja Shekerinska ka zhvilluar një takim në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë ku ka referuar temën: “Përvojat nga përvjetori i parë i anëtarësimit të Maqedonisë Veriore në NATO”.

Shekerinska në Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë

Statusi ynë i ri si një anëtar i NATO-s është eksportues i stabilitetit

Në kuadër të vizitës së saj të punës në Itali, ministrja Radmilla Shekerinska vizitoi Kolegjin e Mbrojtjes të NATO-s në Romë, ku iu drejtua audiencës së kursit të avancuar, në temën “Përvojat nga përvjetori i parë i anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në NATO”. “Maqedonia e Veriut dhe aleatët në Aleancë ndajnë të njëjtat vlera dhe parime të përbashkëta- demokracinë, të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit. “Qasja jonë e përbashkët për të trajtuar të gjitha sfidat e tanishme dhe të ardhshme të sigurisë mbase është përparësia më e madhe e anëtarësimit në aleancën më të fuqishme ushtarako-politike në histori”, -tha ministrja Shekerinska dhe shtoi se Maqedonia e Veriut është ngritur nga një përdoruese në një kontribuese të paqes dhe sigurisë globale, me zërin e saj në formësimin e agjendës së sigurisë së Aleancës. Në institucionin prestigjioz arsimor në Romë për studime dhe kër-

kime mbi çështjet e sigurisë transatlantike, ministrja Shekerinska paralajmëroi për rëndësinë e ruajtjes së perspektivës europiane dhe euro-atlantike dhe integritetit të Ballkanit, si garancia më e mirë për stabilitetin e kësaj pjese të Evropës. “Pas një dekade ngecjeje, Maqedonia e Veriut ka provuar se ekziston zgjidhje për çdo konflikt dhe NATO dëshmoi besueshmërinë e politikës së saj të dyerve të hapura dhe fitoi një aleat tjetër. -Radhën e ka BE”, -tha Shekerinska.


“Maksima e NATO-s është përshtatimi me ndryshimet. Statusi ynë i ri si një anëtar i NATO-s në rajon tani është eksportues i stabilitetit. Angazhimi i Maqedonisë së Veriut ndaj vlerave të NATO-s i jep një shtysë të fortë sigurisë dhe stabilitetit të rajonit. Këto janë edhe vlerat e BE-së. Përgjegjësia është e BE-së për të marrë vendimet e duhura dhe zhbllokimin e europianizimit të rajonit”, -tha Shekerinska.

Në fjalën e saj, ministrja gjithashtu iu referua zhvillimit të aftësive trajnuese dhe stërvitore, veçanërisht të Poligonit Ushtarak Krivollak, “të cilin e zhvillojmë në mënyrë të pavarur, por gjithashtu së bashku me aleatët, si një nga kapacitetet kryesore të Aleancës për Zhvillim të Interoperabilitetit”, -u shpreh Shekerniska. Në kontekstin e zhvillimit të kapaciteteve trajnuese, ministrja nënvizoi Qendrën Rajonale për Marrëdhëniet me Publikun, një qendër e themeluar e NATO-s që do të zgjerohet dhe forcojë kapacitetet e saj në fushën e përbashkët me dezinformata edhe në praktikë, por gjithashtu duke rritur mundësitë për arsim dhe trajnim të personelit vendas dhe të NATO-s të përkushtuar në luftimin e lajmeve të rreme. Me fjalimin e Ministres Sekerinska në Kolegjin e NATO-s në Romë përfundoi edhe vizita e punës në Itali.

Shekerinska takon Nënsekretarin e Shtetit për Politikë Europiane

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska u takua në Romë me përfaqësuesin e lartë të qeverisë italiane, Nënsekretarin e Shtetit për Politikë Europiane, Vincenzo Amendola. Dy bashkëbiseduesit ranë dakord që negociatat e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, në mënyrë që të ruhet besueshmëria e procesit të zgjerimit dhe të dekura-johen idetë për ndryshimin e kufijve në Ballkan, të cilat nënkuptojnë destabilizim të kësaj pjese të Europës. “Vetoja e Bullgarisë dëmton besueshmërinë e procesit të zgjerimit të Bashkimit Europian. Zbehja e perspektivës europiane për vendet e rajonit inkurajon idenë e rishikimit të kufijve dhe ngre alarmin. Ne ndajmë vlerat europiane dhe rajoni nuk duhet të shtyhet përsëri në nacionalizma.

“BE ka përgjegjësi të marrë vendimet e duhura dhe të rinovojë perspektivën Europiane për vendet e rajonit që e meritojnë këtë – kjo është garancia më e mirë për stabilitetin dhe përparimin e rajonit si pjesë e Europës,” -tha ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska në takimin me Nënsekretarin për Politikë Europiane në qeverinë italiane, Vincenzo Amendola. Ai rikonfirmoi pozicionin e Italisë si një mbështetës i fortë i integritetit të plotë të Ballkanit Perëndimor në BE dhe vlerësoi se mospërcaktimi i një date për fillimin e negociatave për Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë me BE-në është një gabim serioz historik që duhet korrigjuar. “Italia do të vazhdojë të llobojë në mënyrë aktive për hapjen e bisedimeve të pranimit sa më shpejt dhe për mbajtjen e konferencës së parë ndërqeveritare sa më shpejt të jetë e mundur,” -tha Amendola.



“Trojan South-2021 përfshinte rreth 120 ushtarakë, pajisje ushtarake dhe armatime si dhe mbi 100 ushtarakë nga Shtetet e Bashkuara, Republika e Maqedonisë Veriore, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Struktura kryesore drejtuese e stërvitjes ishte Komanda e Forcave të Operacioneve Speciale të SH.B.A.-së në Europë (SOCEUR).



Koloneli amerikan Mark W. LaRoche

“Defender Europe-2021”, zhvillohet stërvitja “Trojan South-2021”

Fokusi i stërvitjes ishte rritja e aftësive të Forcave të Operacioneve Speciale të vendeve anëtare të NATO-s nga Ballkani deri në Detin e Zi

Stërvitja taktike e Forcave të Operacioneve Speciale të vendeve anëtare të NATO-s në Europë “Trojan South-2021” u përshëndet nga Komandanti i Komandës së Përbashkët të Operacioneve Speciale (JCC) Gjeneralmajor Yavor Mateev. Ai i mirëpriti pjesëmarrësit e huaj në stërvitje dhe i uroi të gjithëve sukses në kryerjen e detyrave. Stërvitja “Trojan South-2021” u zhvillua nga 3 deri më 14 maj në Bullgari dhe ishte pjesë e një serie ushtrimesh brenda “Defender Europe-2021”. Fokusi i stërvitjes është rritja e ndërveprimit dhe aftësive të Forcave të Operacioneve Speciale të vendeve anëtare të NATO-s dhe partnerëve europianë nga Ballkani dhe rajoni i Detit të Zi për të kundërshtuar kërcënimet e ndryshme në gamën e plotë të operacioneve të Forcave Speciale në mënyrë që të ruajnë paqen dhe stabilitetin në rajon.

“Trojan South-2021 përfshinte rreth 120 ushtarakë, pajisje ushtarake dhe armatime si dhe mbi 100 ushtarakë nga Shtetet e Bashkuara, Republika e Maqedonisë Veriore, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar. Struktura kryesore drejtuese e stërvitjes ishte Komanda e Forcave të Operacioneve Speciale të SH.B.A.-së në Europë (SOCEUR). Qëllimi është të rritet shkëmbimi i informacionit dhe ndërveprimi midis pjesëmarrësve gjatë përgatitjes së përbashkët. “Ushtrimi u përqendrua në përmirësimin e aftësisë së grupeve të Forcave Speciale për t’iu kundërvënë kërcënimeve të ndryshme, si dhe në rritjen e integritetit me forcat konvencionale dhe përmirësimin e ndërveprimit midis Forcave Speciale të vendeve anëtare të NATO-s dhe vendeve partnere,” tha koloneli Mark W. LaRoche, Zëvendës komandant i Komandës së Forcave të Operacioneve Speciale të SH.B.A.-së për Europën. “Më e rëndësishmja, “Trojan South-2021” forcon gatishmërinë ushtarake, zhvillon besimin dhe marrëdhëniet e



qëndrueshme që promovojnë paqen dhe stabilitetin në të gjithë Europën,” shtoi ai.

Përveç Bullgarisë, “Trojan South-2021” zhvillohet në Mal të Zi, Republikën e Maqedonisë Veriore dhe Rumani. Aleatët dhe partnerët e tjerë pjesëmarrës ishin Forcat Speciale të Gjeorgjisë, Gjermanisë dhe Ukrainës. Stërvitja ofroi një mundësi për të provuar dhe përmirësuar taktikat, teknikat dhe procedurat në aktivitetet ushtarake

në tokë, ajër dhe ujë. “Trojan South-2021” ishte stërvitja më e madhe e Forcave të Operacioneve Speciale në Europë. Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë dhe besimin se ishim një nga vendet pritëse”, tha gjeneralmajori Yavor Mateev. “Ky ushtrim na mundësoi të forcojmë aftësitë tona për t’iu kundërvënë kërcënimeve rajonale dhe gjithashtu kontribuon në përmirësimin e aftësive tona operacionale dhe aftësive të NATO-s,” shtoi ai.

“Siguria e atdheut dhe Europa-Izrael 2021”

Konferenca u organizua nga platforma izraelite Improvate

“Nga pikëpamja e sigurisë kombëtare, domosdoshmëritë e mëposhtme janë kritike: ndërgjegjësimi i situatës dhe informacioni përkatës në lidhje me zhvillimin dhe zbatimin e teknologjive inovative me një efekt shkatërrues, koordinimi dhe planifikimi ndërlikas-terial, trajnime dhe ushtrime të përbashkëta.” Kjo u deklarua nga Shefi i Mbrojtjes Admirali Emil Eftimov gjatë pjesëmarrjes së tij në video-konferencën “Siguria e atdheut dhe Europë-Izrael 2021”, organizuar nga platforma izraelite Improvate.

Lidhur me zhvillimin e Forcave të Armatosura dhe trajtimin e sfidave

të përmendura, Admiral Eftimov theksoi se qasja konvencionale për zhvillimin e aftësive mbrojtëse është e shtrenjtë dhe joefikase. Ai theksoi se natyra e operacioneve luftarake gjatë konflikteve të fundit karakterizohet nga larmia e



përdorimit të sistemeve të kontrol-luara në distancë, mbrojtja efektive kibernetike dhe elektromagnetike e sistemeve të komandimit, kontrollit dhe shënjestrimit. “Ne nuk jemi larg nga zbatimi gjerësisht i sistemeve të inteligjencës artificiale në ndikimin kinetik. Qasja adekuate duhet të bazohet në zbatimin efektiv të sistemeve inovative të mbrojtjes për mbrojtje dhe kundërveprim, në vend të sistemeve të shtrenjta dhe konvencionale në kuptimin e tyre të mbrojtjes”, -ishte kategorik Admiral Eftimov. Forumi u ndoq nga ekspertë të sigurisë dhe sigurisë kibernetike, politikanë dhe përfaqësues të biznesit.

Anijet antimina realizuan stërvitjen në det

Divizionet detare të anijeve luftarake dhe anijeve ndihmëse zhvilluan ushtrime taktike në det. Divizioni i Veprimit ndaj Minave, i stacionuar në Stacionin Bazë të Varnës, i përbërë nga anija antimina “Cibar” dhe depouesit e minave “Kapiten-Toger Evstati Vinarov” e “Kapiteni igrades së I-rë Dimitar Paskalev”, realizuan trajnimin për të zmbarsur sulmet e ajrit të armikut, duke qëlluar në ajër shënjestrat me një sistem të lëvizshëm raketash anti-ajrore dhe zbulimin dhe shkatërrimin e minave fundore pa kontakt. Për të garantuar sigurinë e lundrimit, u realizua një studim sistematik i rrugëve detare në mënyrë që të mblidhen informacionet e kontaktit për minat detare të pazbuluara deri më tani. Anijet e detashmentit të anijeve ndihmëse, të vendosura në stacionin Bazë të Burgas, kryejnë ushtrime dhe stërvitje luftarake. Këto përfshinin qitjen e raketave ajrore, kryerjen e detyrave për të ndihmuar një anije të dëmtuar, trajnimin me një skaf dhe më shumë.

Fregata “Gordy” ka kryer një stërvitje taktike. Ekuipazhi realizoi detyra në lidhje me kërkimin e nëndetësve në një zonë të caktuar, kontrollin e lundrimit, gjuajtjen në det dhe në shënjestrat ajrore, vendosjen e shënjestrave të rreme të radarit, mbrojtjen e anijes nga armët bërthamore, kimike dhe biologjike dhe luftën për mbijetesën e anijes.

Një divizion i anijeve patrulluese dhe një divizion i anijeve me detyra ndihmëse, të vendosur në Stacionin Bazë të Varna, kanë përfunduar ushtrimet e tyre taktike. Stërvitja ishte jashtëzakonisht dinamike, plot stërvitje luftarake dhe kontribuo shumë në përmirësimin e aftësive profesionale dhe trajnimin e personelit në kryerjen e detyrave në det.

Gjatë ushtrimit taktik të divizionit të patrullës, për herë të parë, gjendja e fushës magnetike të bykut të korvetave “Reshitelni” dhe “Bodri” u krye në një poligon të vendosur në një ankorim. Është kryer një procedurë për evakuimin e një ushtari të plagosur nga bordi i një aeroplani, me pjesëmarrjen e korvetës “Bodri” dhe një helikopter AS 565 MB “Panther” nga përbërja e bazës ajrore të helikopterit detar “Chaika”. Është kryer një procedurë për pranimin dhe dorëzimin e municioneve të silurës në det në një ankorim me pjesëmarrjen e korvetës “Bodri” dhe një varke hidrografike nga Shërbimi Hidrografik i Marinës. Gjatë stërvitjes, ekuipazhi i korvetës “Bodri” kreu një procedurë lëshimi silure.



Beteja e Meçovës dhe 800 dëshmorët e saj në mbrojtje të Arbërisë

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Situata politike, por sidomos ushtarake në gadishullin Ballkanik, në vitet 1852-1854, ishte tejet e ashpërsuar, ndërkohë që pritej ndryshim dhe rikonceptim i hartës rajonale ballkanike, Europiane gjeopolitike e më gjerë. Osmanët ishin dobësuar dhe konsumuar shumë pas shumë lufrash e pushimesh dhe kishte ardhur koha që të mblidheshin në strofullën e vet. Rusia po punonte fort ta shfrytëzonte këtë situatë nëpërmjet flamurit të ortodoksisë për turbullira që të fitonte terren e të realizonte synimet. Britania kjo “luaneshë e deteve” e njohur për platformën e “interesave të përjetshme” kërkonte të mbronte pozitat e saj në ishujt jonianë dhe të mos lejonte përhapjen e influencës ruse në Ballkan; ndërsa Franca ishte në qëndrim të distancuar neutral. Rusia, ja kishte gjetur “thembrën e Akilit” tedencës greke për “Vorio-Epirin”, por edhe pretendimet e pandalshme për territorin shqiptar deri në Shkumbin, gjë që nxiti Greqinë në jug dhe Malin e Zi në Veri ta fusnin Shqipërinë në “darën” e dy fronteve të luftës. Spiro Milo i joshur me flori dhe grada nga grekët u përdor në krye të bandave greke në Himarë dhe prej andej të pushtonte Vlorën. Nga Çamëria, Arta, Peta, Mecova dhe deti ishin nxitur kryengritje me kërkesa vorio-epirote. Gazetat dizinformonin se: “Grekët kanë grupe të shumta luftimi në Janinë, në Çamëri, ata kanë arritur deri në Himarë... dhe mund të bashkohen me banditët e Malit të Zi”.

Në fund të janarit 1854, Spiridon Karaiskaqi me gradën nëntoger në ushtrinë greke, por dhe i biri i heroit të pavarësisë greke Jorgo Karaiskaqi, “zhveshi shpatën” dhe mbajti në lindje të Artës, në disa fshatra, fjalime që u bënë thirrje banorëve kundër osmanëve dhe t’i bashkoheshin Greqisë. Kishte “braktisur”, detyrën dhe ishte kushtuar “orës së lirisë” për pavarësi nga osmanët. Ai mundi të mblidhte 2500 vullnetarë dhe synoi qytetin e Artës. Ndërkohë, gjenerali grek Teodor Griva kishte mbledhur një bandë prej rreth 300 “vullnetarësh”, i ishte afruar Çamërisë së Mesme, deri në fshatin Dhrohomi. Edhe pse osmanët morën “masa” ushtarake e diplomatike, duke sjellë edhe përf forcime nga Manastiri, nuk mjaftonin pa vullnetarët e redifët e Labërisë, krahinave të Përmetit e Çamërisë. Oficerë me prejardhje suliotë në ushtrinë greke si Nikola Zerva, Noti Boçari, Athanas Kuzonika, Kiço Xhavella, Llambro Ziko, dhanë dorëheqjen nga pozicionet e tyre në ushtrinë dhe u bashkuan kryengritësve.

Por Arta u rrethua nga rreth 5000 trupa ushtarake e vullnetare, por dhe artileria e rëndë. Këtu lufta ishte si provokim nervash. Grekët kryengritës, ku brenda tyre edhe përzjerje interesash më 15 mars 1854 kishte rreth 6000 trupa. Ata kishin pushtuar disa fshatra, burgosnin banorët, vidhnin pronat, pasurinë, thesaret e grave dhe i nisin në Greqi. Sulmi ishte ndaj muslimanëve, por dhe të krishterët. Kryengritësit bënë masakra çnjerëzore në Mecovë me Grivën në krye me vrasje makabre, vjedhje e djecave. Koha thirri në skenë Çelo Picarin e forcave vullnetare labe: “Ngreu Çelo, bën zananë./ngjesh pisqoll’ e jataganë./të bëç dufek me Junanë!/Kapetan Griva ka dalë./mbushi vëndin me andarë./ Del, ore Çelo Mehmeti./se këtu u bë gazeipi./dolli Junani nga deti./na përvëloi laneti!/Kur u derth Çelo Picari./si purtek’u drooth Junani...”. Osmanët u bësonin më shumë armëve se askerëve të tyre. Besim kishin tek redifët e vullnetarët e Labërisë. Kujtesa e arkivave osmane flet për një betejë dy ditore 25 deri më 27 mars 1954, luftime të shqiptarëve që zgjatën 48 orë. Më 27 Mars 1854 triumfator dolën forcat shqiptare të Mahmud bej Vlorës, (i ati i Ismail Qemalit): “Erdhi kartë nga Mecova,/bën dufek Mahmud bej Vlora,/Në male pa tretur bora,/e mblodhi Grivën sa dora...”. Lufta zhvillohej edhe në Thesali, ku shqiptarët drejtoheshin nga nga Abaz Lialioti. Bandat andarte greke në tokën jugore shqiptare kryen sulme të rrezikshme dhe krime monsturoze të përgjakshme. Kjo i detyroi strukturat prejtuase politike, ushtarake dhe administrative të pushtimit osman të mobilizonin forcat osmane të pamjaftueshme dhe të thërrisinin për ndihmë emergjente me premtie edhe redifët e vullnetarë shqiptarë. Për të mënjeluar copëtimin e truallit arbëror, bijtë e krahinave jugore shqiptare morën përsipër mbrojtjen e integritetit tokësor jugor të vendit, për rrjedhojë të vilajetit.

Kapedanë dhe luftëtarë që të merrnin

(Në kujtim të 800 dëshmorëve të rënë në Luftën e parë në mbrojtje të Vilajetit të Janinës, kushtuar kapedanëve të kësaj lufte e veçanërisht Dëshmorëve të Atdheut të fshatit Fushëbardhë Bajo Kazo (1820-1854) dhe Habil Xhuvani (1824-1854), rënë në betejë si pjesë e krenarisë së luftëtarëve, që i dhanë nder dhe krenari Labërisë me epopenë e trimërisë dhe gjakun e derdhur për liri. Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani janë dy dëshmorët e parë për nga radha e rënies dhe evidentimit të dokumentuar të fshatit Fushëbardhë të Gjirokastrës. Ata ranë në fushëbetejë në pranverën e vitit 1854 dhe janë në proces për t’u shpallur dëshmorë të Atdheut në zbatim të Ligjit nr. 109/2018, datë 20.12.2018, “Për statusin e Dëshmorit të Atdheut”, neni 5 “Kriteret për shpalljen e statusit “Dëshmor i Atdheut”; Pika “a”) personat, të cilët kanë humbur jetën për lirinë, pavarësinë kombëtare dhe mbrojtjen e territoreve shqiptare apo në përpjekje për mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe para datës 28 nëntor 1912).



gjak në vetull u rreshtuan për mbrojtjen e truallit të të parëve që ishte në rrezik. Burrat që kishin ardhur të parët në xhephanen e fushëbetejës në Mecovë ishin: Mahmud bej Vlora, Selim pashë Vlora, Halit bej Frashëri (babai i frashëllinjëve të mëdhenj), Çelo Picari dhe Kalem Hadëri nga Picari i Kurveleshit, Bajo Kazo e Habil Xhuvani nga Fushëbardha, Ibrahim Sino nga Gjirokastra, Ahmet Çapari nga Luarat i Margëlliçit, Selam Hasani nga Velça e Vlorës, Hasan Çako nga Kaparieli, Shako Xhaka nga Tërbaçi i Vlorës, etj. Shumica e këtyre prijësve e luftëtarëve që ishin komandantë me kordhë në dorë, kishin qenë organizatorë, udhëheqës e luftëtarë në vijën e parë në kryengritjen e madhe fshatare edhe më parë dhe ishin liruar nga internimi që osmanët u kishin bërë në vitet antitanzimat 1847-1848. Krahaskapedanëve dhe luftëtarëve të ardhur u rreshtuan edhe Mulla Qemal Bejtashi (rënë në betejë), Hamit bej Çapari, Zejnel Husa etj. Arta dhe rajonet malore të Epirit u shndruan në vatra të kryengritjeve masive. Kapedanit të Labërisë Mahmud bej Vlorës, që sprapsi grekët, ju thur menjëherë kënga: “Mahmud bej me tre milë (mijë)/Dual milleti i prinë/Nuk e mbanin dot gëzimë/Kur murzikat po i bijnë...”. Edhe pse kanë kaluar mbi një shekull e gjysmë nga zhvillimi i kësaj lufte si dhe rrethanat historike kanë ndryshuar shumë, historia ngelet, kujtohet e nuk harrohet. Sakrificat, gjaku i tyre, këngët e gjalla, të paharruara këndohen si një thirrje për të ardhmen paqësore bashkëjetuese në një organizëm të përbashkët madhor të sigurisë së kombeve. Është fakt se banorët e krahinave të Rrëzomës, Kardhiqit, Kurveleshit, Lumit të Vlorës e të gjithë Labërisë, edhe sot ta kujtojnë luftën e Mahmud bej Vlorës me shokë në Mecovë. Kjo besohet edhe nga këngët e shumta që u ngritën, që kujtohen e përkujtohen por mbi të gjitha që përcillen gojë më gojë në popull. Është historia e një populli të tërë, që mbahet mend e tregohet edhe sakrifica që bëri Mahmud bej Vlora para dhe pas përfundimit të luftës që “shiti në Vlorë dhe në Berat shtatë çifiligje, sikurse shkruan Eqrem bej Vlora në kujtimet e veta, për të shpërblyer çetarët (jo pak por rreth dy tabure), që morën pjesë në luftë e që ngeli edhe fukara, duke ua përcjellë atë bijve të vet”. Ka qenë një lavdi e shkruar me vullnetarizëm, por mbi të gjitha me shumë gjak të derdhur.


Në vitin 1854 Greqia sulmon pjesë të truallit shqiptar, dhe synonte të merrte

nipin e tij, Kalem Hadëri (Seferi), vijojnë të mbajnë nismën duke çliruar Artën, Prevezën dhe skelën e Salahorës. Ndërsa në drejtim të Mecovës shkoi Mahmud bej Vlora. Kishin hyrë në veprim komandantë e luftëtarë të sprovuar. Shqiptarët ishin në profesionin e tyre dhe e njihnin mirë “teatrin e veprimeve luftarake”. Fakt ishte se jo vetëm kërret e kapedanët e Labërisë, dhe krahinave të tjera, por edhe gjithë orduja (ushtria) e luftëtarëve të të gjitha niveleve kishin një përgatitje perfekte luftarake, kishin njëherazi eksperiencë në luftë, të njohur për trimërinë nëpër betejë sepse “luftën e kishin për traditë e zakon” dhe ky zakon trashëgohej brezave. Grekët u shpartalluan me përfundimin e pranverës së vitit 1854, por meritat i mori hykime (qeveria) e Sulltanatit, ndërkohë që gjakun e derdhën pa kursim lehtërit në mbrojtje të truallit arbëror. Edhe pas këtyre betejave kënga la dëshminë e saj: Burra ku shtoftë oxhaku/Shehitë kërkon sanxhaku/Bëni djem prag pas pragu./Hasmit t’i vijnë hakut...”. Forcat e Dangëllisë dhe Dëshnicës që drejtoheshin nga Halit Bej Frashëri, ishin përballur me bandat greke të udhëhequra nga gjeneral Theodor Griva së bashku me djalin e tij, oficerin madhor Dhimitër Griva. Ata ishin të dërguarit kryesorë të qeverisë greke në Epirin shqiptar për të realizuar pushtimin e trojeve shqiptare. Zbarkimi i Grivës fshehtazi në brigjet e Nartës e Prevezës, marshoi në Çamërinë Lindore, ku ishin fshatrat çame me popullsi myslimane me djegje e shfarosje arritën deri në lumin Kalama, Muzinë e Butrint, me moton: “Përpara, me kryqin në njërin dorë dhe në dorën tjetër thikën!” Dhe e gjithë kjo në emër të Greqisë të të kryqit...! Por kur e panë që nuk ja dolën ata dogjën 183 shtëpi të shqiptarëve në Mecovë dhe u shkaktua një gjakderdhje e madhe, ku grekët patën disfatën e parë dhe shqiptarët dmth osmanët fitoren e parë ndaj një shteti njëzetvjecar të Greqisë të uritur për troje në dëm të vëllazërisë gadishullore.

Por në këto luftime në rrethinat e Mecovës u vranë edhe dy bij trima të fshatit Fushëbardhë, Bajo Kazo dhe Habil Xhuvani, të cilët edhe pse u varrosën “ku i zinte balta”, atje në Mecovë ngjelen përjetësisht në memorie të kombit si “dëshmorë të rënë për truallin arbëror”, sepse ata kishin lindur në një djep lufte, në Fushëbardhën e bardhë të këngës, të trimërisë, të mcurisë. Prandaj edhe populli i shkroi në këngë që të mos harroheshin kurrë: “Mecovë e bukur në pllajë./Mos mbaj zi për kordhëtarë./ (Kordhë- shpatë e kthyer pak në majë; këllëç, shpata, palla, sëpat, jatagani)/Për djemtë e Labërisë./Korjuxhu (koruyucu) të sinorisë./ (ruajtësit e kufirit)/Tepeleas e Vlonjatë./Që rojnë me bukë thatë./Me mish të pjekur në napë./Ja bënë fora atë natë./Për truall, për tokën tënë./Dushman nuk do lëmë në këmbë./Luftë në truallin ilir./E lanë me gjak lirinë./Lebër trima xhevahirë...”. Trimat e saj, fshati Fushëbardhë i kishte nisur për luftë për truallin e të parëve dhe ishin trima të “zgjedhur me dorë”: Bajo Kazo, Habil Xhuvani dhe luftëtarë të tjerë nga fiset: Yzeiri, Bineri, Çarçani, Golemi, Veliu, Onjea, Shalari, Shkurti, Kazo, Xhuvani, Poçi, Shehu, etj., rreth tridhjetë luftëtarë, trima që “luftën ua hante syri”.

Që të gjithë dalloheshin për burra të fortë, trima, të mençur prej natyre, të përbashkuar në front lufte ishin tepër të fuqishëm, të zotë dhe mjaft të aftë dhe si prijës ushtarak betejë, burra që mundjen burrërishte e kishin një ndër “lojrat” e ushtrimeve luftarake, që dinin të godisin në shenjë, që vargjet e këngës, i ngrinin nëpër betejë dhe po në betejë i këndonin. Në fshat nuk erdhën të rënë por më parë erdhi kënga e tyre, më e madhja e shekujve: “Mecova larë me gjak, /Luftojnë bijtë nën një bajrak, .../Bëjnë harb(luftë) me junanë./Flakë e ndezën vatanë./ U vranë ca trima

të rrallë./Labëri çli bëre lotë./I derdha për ca luanë./.../Për Bajon (Kazo) dhe për Xhuvanë (Habil Xhuvani)...”. Kënga tjetër flet më shkurt, më prerë dhe më luftarake: “Në Fushëbardhë dy nishanë./Bënë harb me junanë./Xhanin dhanë për vatanë./Habili(Xhuvani) me Bajo Kazë, (Kazo)/...”. Më 6 qershor 1854, tre grupime kryesore forcash të Mahmud bej Vlorës, të Çelo Picariit dhe të Halit Bej Frashërit vijuan triumfin, sikurse në Nartë, Petë, Kallabak, Mecovë etj. Në fakt fitorja në betejën e Mecovës bëri që të dështonin plotësisht tentativat e qeverisë shovene greke për pushtimin e trojeve të Shqipërisë së Jugut gjatë vitit 1854. Prandaj për këtë arsye poeti popullor këndonte: “Arbëri, kështjellë e fortë./Kalaja që nuk merret dot./As me lajka, as me top./Trimat se ctë dalin zot./...Lebër zorgjedh levendë./Tetëqind në betejë mbenë./na mderuan Vilajenë...”. Në betejat për mbrojtjen e Vilajetit të Janinës, numri i të rënëve, vetëm në Mecovë dhe rrethinat e saj përlllogaritet në rreth tetëqind të rënë dëshmorë për amanetin e të parëve, për truallin e lënë trashëgim, tetëqind të ngelur në këngë. Në ndihmë të forcave shqiptare, që luftonin në front shkuam edhe qindra luftëtarë (mendohet rreth dhjetë mijë luftëtarë të tjerë nga Labëria, por e pavërtetuar plotësisht me dokumente). që u pozicionuan për mbrojtjen e Mecovës e Artës. Në Betejën e përgjakshme të Mecovës, ku e drejtonte grekët Griva u vra dhe komandanti velçjot trimi Selam Hasani. Kënga u këndua në mbarë Labërinë: “Kush u hodh proto Mecovë./Selami vetullahollë./Forra me pallë në dorë./Gremisi katër taborrë./Selam, bajraku që s’jepe,/Shtatë plagë e nuk u stepe...”. Një ndër betejat më të përmendura në luftën e vitit 1854 është betejë e 13 Prillit 1854, ku 6000 trupa osmane dhe sidomos vullnetare të mbështetura nga artileria në Peta, në lindje të Artës, ku pas një betejë të ashpër e të përgjakshme pas humbesh të mëdha, Kiço Xhavella me njerëzit e tij u tërhoq në jug, në kufijtë e shtetit grek. Redifët vullnetarë të tjerë shkuan më në veri për të asgjësuar çdo lëvizje përreth qytetit të Janinës. Pati edhe luftime ku osmanët u tërhoqën dhe shqiptarët u mbrojtën dhe sulmuan deri të vetëm duke pasur edhe humbje të rënda. Nisur nga pikëpamja diplomatike dhe marrëdhëniet e osmanëve me flotën anglo-franceze e detyruan atë që të bllokonte portin e Pireut dhe disa porte të tjerë, duke penguar furnizimin e kryengritësve duke ushtruar presion mbi qeverinë greke të tërhoqte oficerët e saj. Pas shumë betejave të pranverës së vitit 1854, përfshi edhe ato në Vulgarel, Skullikarë, Kleidi më 12 Maj 1854 kryengritja andarte u shtyp. Trupat andarte greke u tërhoqën brenda kufijve grekë, edhe pse në mënyrë sporadike vazhduan të kishin probleme bandisteske të veçuara. Vera e vitit 1854 i gjeti trojet jugore shqiptare të çliruara nga pushtuesit greko-rusë, por me shumë gjak shqiptari të derdhur për këto troje. Pushtuesi osman kësaj here është pushtuesi i tokës shqiptare që u shpëtua nga vetë shqiptarët, që në fakt mbronin tokën e tyre të pushtuar. Betejat e kapedanëve të Labërisë duke e analizuar më gjerë, flasin qartësisht se shqiptarët gjithmonë kanë ruajtur me fanatizëm trojet duke sakrifikuar dhe jetën e tyre për t’i mbrojtur ato. Gjithë qëllimet dhe orekset shovene ndaj trojeve dhe shqiptarëve kanë gjetur gatishmëri kundërpërgjigje dhe kjo është një përvoja historike reale, që nuk mban asnjë lloj shtrëmbërimi të asnjë lloj “historiografie” të paguar, ndërkohë që trimërinë shqiptare e kanë njohur miq dhe armiq dhe ky është mësim historik që nuk ka nevojë për “solistikim” të kohëve moderne edhe kur jemi në një organizatë madhore sigurie, edhe kur synojmë të jemi bashkë në një organizëm gjigand të përbashkuar ekonomik. Janë me qindra e mijëra trimat e kryengritjeve popullore të kombit shqiptar, që gjakun e kanë derdhur në fushëbeteja shekujve, sepse nuk duronin robërinë e shekujve dhe kjo jo vetëm në Labëri por në mbarë truallin arbëror, duke bërë detyrën morale ndaj kombit.



"DEFENDER EUROPE 21": AMBASADA AMERIKANE PUBLIKON PAMJE:

Anija logjistike "James A. Loux" zhvillon stërvitje në Detin Adriatik

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Shqipëri publikoi në rrjetet sociale video dhe foto nga stërvitja e përbashkët ushtarake "Defender Europe 21", që ka nisur prej disa ditësh në Shqipëri. Ambasadë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës "Anija ushtarake e furnizimit logjistik "James A. Loux" zhvilloi fundjavën e kaluar disa manovra ushtarake dhe stërvitje në Detin Adriatik pranë Durrësit", thekson Ambasada e SHBA-së. "Trajnimi i ekuipazhit përfshinte një stërvitje për shuarjen e zjarrit dhe evakuimin e njerëzve. Një varkë shpëtimi u nis nga anija për të rimarrë një anëtar të ekuipazhit", -shton Ambasada amerikane. "LSV James A Loux" është në Portin e Durrësit për të marrë pjesë në stërvitjen ushtarake Defender Europe 21, si pjesë e operacionit të përbashkët për të transportuar automjete dhe pajisje ushtarake nga USNS Bob Hope në Shqipëri", -shkruhet në mesazhin e Ambasadës së SHBA-së.

